

# DORACAKU I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË SSSH-SË 2017-2021



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë  
Ministarstvo Zdravstva  
Ministry of Health



DHJETOR 2017



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë  
Ministarstvo Zdravstva  
Ministry of Health

# **DORACAKU I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË SSSH-së 2017-2021**

DHJETOR 2017





## PËRMBAJTJA

<b>1. SHKURTESAT .....</b>	<b>4</b>
<b>2. HYRJE .....</b>	<b>6</b>
2.1. Fushëveprimi dhe përdorimi i Doracakut .....	6
2.2. Parimet udhëheqëse.....	6
2.3. Struktura e Doracakut .....	7
2.4. Terminologjia e M&V dhe përkufizimet .....	8
<b>3. SISTEMI I M&amp;V .....</b>	<b>12</b>
3.1. Kriteret e përzgjedhjes së indikatorëve .....	12
3.2. Analiza teknike e indikatorëve .....	13
3.3. Përshkrimi i Sistemit të M&V.....	21
3.4. Rolet dhe përgjegjësitë e M&V.....	21
3.5. Mbledhja e të dhënave .....	24
3.6. Agregimi i të dhënave.....	25
3.7. Analiza e të dhënave.....	26
3.8. Përmbledhja të dhënave.....	27
3.9. Matrica .....	30
3.10. Matrica e Vlerësimit dhe Menaxhimit të Rrezikut.....	41
3.11. Raportimi.....	46
<b>4. SHTOJCAT .....</b>	<b>47</b>
4.1. Formularët e Indikatorëve .....	47
4.2. Korniza logjike e SSSH 2017-2021 .....	383

## 1. SHKURTESAT

<b>AKPM</b>	Agjensioni Kosovar për Produkte Medicinale
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>BD</b>	Bordi Drejtues
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BNj</b>	Burimet Njerëzore
<b>BPV</b>	Bruto Produkti Vendor
<b>DKPSh</b>	Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor
<b>DL</b>	Departamenti Ligjor
<b>DZhS</b>	Departamenti për Zhvillim Strategjik
<b>EVM</b>	Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor
<b>FI</b>	Formulari i Indikatorit
<b>FSSH</b>	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
<b>GNS-KRAM</b>	Grupi Ndërsektorial për Kontrollin e Rezistencës Antimikrobiale
<b>GPNS</b>	Grupi Punues Nën-sektorial
<b>HFA-DB</b>	Health for all – Database (Shëndeti për të gjithë – Baza e të dhënave)
<b>IKShP</b>	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
<b>IPSh</b>	Institucion Publik Shëndetësor
<b>KASh</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
<b>KDSh</b>	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KPSh</b>	Kujdesi Parësor Shëndetësor
<b>KTSh</b>	Kujdesi Tretësor Shëndetësor
<b>M&amp;V</b>	Monitorimi dhe Vlerësimi
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MBR</b>	Menaxhimi i Bazuar në Rezultate
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MIE</b>	Ministria e Integritimit Evropian
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>MR</b>	Rezonanca Magnetike
<b>MSh</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MVMRr</b>	Matrica e Vlerësimit dhe Menaxhimit të Rrezikut
<b>NCD</b>	Noncommunicable diseases (sëmundjet kronike jorgjitëse)
<b>OECD</b>	Organisation for Economic Cooperation and Development (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)
<b>OFPK</b>	Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës
<b>OIK</b>	Oda e Infermierëve të Kosovës



<b>OMK</b>	Oda e Mjekëve të Kosovës
<b>OP</b>	Odat Profesionale
<b>OPSh</b>	Odat e Profesionistëve Shëndetësorë
<b>OSK</b>	Oda e Stomatologëve të Kosovës
<b>PMM</b>	Platforma për Menaxhimin e Mbështetjes
<b>QA</b>	Sigurimi i Cilësisë
<b>QeK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>QEVl</b>	Qendra për Edukim të Vazhdueshëm të Infermierisë
<b>QKMF</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
<b>QKSUK</b>	Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës
<b>QKUK</b>	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
<b>QMF</b>	Qendra e Mjekësisë Familjare
<b>QORr</b>	Qendra Operative e Rrjetit (e SISH-it)
<b>QQT</b>	Sasia, Cilësia dhe Koha
<b>QZhs</b>	Qëllimet Zhvillimore Strategjike
<b>RCGP</b>	Kolegji Mbretëror i Mjekëve të Përgjithshëm
<b>SISH</b>	Sistemi i Informimit Shëndetësor
<b>SMART</b>	Specific, Measurable, Achievable, Relevant, Time Bound (Specifikë, të matshëm, të arritshëm, relevantë, me afate kohore të përcaktuara)
<b>SP</b>	Spitali i Përgjithshëm
<b>SSSh</b>	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017 – 2021
<b>STEPS</b>	Hulumtimi gjithëpërfshirës për faktorët e rrezikut të sëmundjetve jongsjtitëse
<b>ShSKUK</b>	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
<b>TB</b>	Tuberkuloza
<b>TeR</b>	Termet e Referencës
<b>TI</b>	Teknologjia Informativë
<b>UNDP</b>	United Nations Development Programme (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim)
<b>ZhVP</b>	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

## 2. HYRJE

Doracaku i Monitorimit dhe vlerësimit (M&V), ofron përshkrimin e hollësishëm të sistemit të M&V, i cili është zhvilluar për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021 (SSSh). Dokumenti përfshin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me strukturën dhe funksionimin e sistemit të M&V gjatë pesë viteve të ardhshme, me mundësi të rishikimit.

Me Vendimin e Qeverisë nr. 07/120 të datës 14.12.2017, është miratuar SSSH 2017-2021, dokument ky në të cilin është përfshirë edhe fuqizimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të këtij dokumenti. Ministria e Shëndetësisë (MSh), zbaton sistemin e M&V, ndërsa të gjithë akterët e tjerë obligohen të raportojnë siç është e përcaktuar në këtë Doracak.

Qëllimi i sistemit të M&V është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e SSSH-së, bazuar në të dhënat zyrtare, për vendime të bazuara në dëshmi për Ministrinë e Shëndetësisë.

Doracaku shfrytëzohet nga të gjithë akterët e përfshirë në sistemin e M&V, ku gjejnë informatat e nevojshme për të përmbushur me sukses rolin e tyre në mbledhjen, agregimin, analizën dhe shpërndarjen e të dhënave.

Krijimi i sistemit të M&V është rezultat i punës së përbashkët të të gjithë akterëve hisedarë në SSSH, me mbështetjen e Agjencisë së Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

### 2.1. FUSHËVEPRIMI DHE PËRDORIMI I DORACAKUT

Fushëveprimi i Doracakut të M&V përfshin të gjitha institucionet hisedare si dhe partnerët e tjerë strategjikë të përfshirë në SSSH. Ky dokument shërben edhe si instrument për zbatimin e sistemit të M&V, në periudhën afatmesme pesë vjeçare.

Doracaku i M&V është dokument dinamik i cili do të rishikohet në intervale të rregullta kohore me qëllim të përfshirjes së informatave kthyesë nga akterët shëndetësorë të përfshirë në zbatimin e SSSH 2017-2021 si dhe sistemin e ndërlidhur të M&V. Përditësimet mund të bëhen si rezultat i shtrirjes së sistemit, metodologjisë së mbledhjes, dhe analizës së të dhënave. Formularët e indikatorëve janë hartuar në bashkëpunim me akterët përkatës shëndetësor, të cilët përkufizojnë dhe krijojnë procedura dhe rrjedha të informatave, të cilat ende nuk konsiderohen si praktika të zakonshme nga institucionet shëndetësore. Gjatë viteve të para, përgjegjësitë dhe detyrat në formularët e indikatorëve mund t'iu nënshtrohen ndryshimeve.

### 2.2. PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet udhëheqëse gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit janë:

#### ■ Gjithëpërfshirja

Në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë sektorët dhe institucionet hisedare në SSSH. Gjatë aktivitetit të krijimit të sistemit të monitorimit, si parim udhëheqës ka qenë që të vepohet sipas strukturës organizative të sektorit të shëndetësisë të Kosovës. Sistemi i M&V mbështet fuqizimin organizativ të sektorit duke vlerësuar kompetencat e veçanta dhe



historinë e gjatë dhe të rrënjosur të institucioneve shëndetësore. Si komponent më i prekshëm i ngritjes së kapaciteteve institucionale janë procedurat e brendshme dhe mekanizmat administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Sistemi i M&V synon t'i përforcojë ato instrumente, ku në këtë drejtim respekton procedurat administrative ekzistuese. Nuk pritet të krijohen mjete "ad hoc" për monitorimin e SSSH-së. Theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe të sektorëve tjerë të përfshirë.

### ■ Udhëheqja

Ministria e Shëndetësisë ka rol udhëheqës në procesin e monitorimit dhe vlerësimit, që është e përcaktuar me aktet ligjore në fuqi.

### ■ Thjeshtësia

Sistemi i M&V është dizajnuar për të qenë sa më i thjeshtë. Të kuptuarit dhe pjesëmarrja në përcjelljen e rrjedhës së informatave, procedurave dhe të dhënave duhet të jetë e shpejtë dhe e lehtë për çdo përdorues të doracakut.

## 2.3. STRUKTURA E DORACAKUT

Doracaku i M&V përmban përshkrimin e sistemit të M&V dhe shtojcat (formularët e indikatorëve).

### 1. Pjesa e parë përshkruan sistemin e M&V dhe përbëhet nga pjesët në vijim:

- Objektivat: qëllimet e zbatimit të sistemit të M&V për SSSH-në.
- Kriteret e përzgjedhjes së indikatorëve: gjatë fazës së parë të përzgjedhjes së indikatorëve për çdo rezultat të SSSH-së, institucionet shëndetësore përgjegjëse kanë vepruar në bazë të një grupi kriteresh.
- Analiza teknike e indikatorëve: secili indikator është analizuar nga këndvështrime të ndryshme, duke definuar pse është përzgjedhur; cili institucion do t'i mbledhë të dhënat në lidhje me të; dhe cili institucion do t'i analizojë të dhënat. Përshkrimi i sistemit të M&V: përshkrimi i përgjithshëm i nivelit të zbatimit të sistemit të M&V.
- Rolet dhe përgjegjësitë e M&V: prezantimi i hollësishëm i detyrave të akterëve shëndetësor që luajnë rol në zbatimin e sistemit të M&V të SSSH-së.
- Mbledhja e të dhënave: institucionet shëndetësore të përfshira në mbledhjen e të dhënave paraqiten me anë të diagramit.
- Agregimi i të dhënave: institucionet shëndetësore të përfshira në agregimin e të dhënave paraqiten me anë të diagramit.
- Analiza e të dhënave: institucionet shëndetësore të përfshira në analizën e të dhënave paraqiten me anë të diagramit.



- Përpilimi i të dhënave: për çdo indikator përcaktohet periudha e saktë e vitit në të cilën duhet të kërkohen të dhënat nga institucionet që i mbledhin ato, me anë të një tablele.
- Matrica e M&V: një tabelë që përcakton për çdo indikator periudhën e mbledhjes, përgjegjësinë për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, si dhe sistemin prej tre pragjesh (i gjelbër, i verdhë dhe i kuq), për të treguar nivelin e arritur të realizimit.
- Matrica për Menaxhimin e Vlerësimit të Rrezikut (MMVRR). Kjo tabelë i përmbledh rreziqet për realizimin e SSSH-së që janë përtej kontrollit të SSSH-së.
- Raportimi: në këtë paragraf prezantohet formati i raportit vjetor të M&V.

2. Pjesa e dytë e Doracakut të M&V përbëhet nga shtojcat, të cilat përfshijnë 63 Formularë të Indikatorëve (FI) të ndërlidhura me çdo objektivë strategjike, objektivë specifike dhe rezultat të SSSH-së.


- Formularët e Indikatorëve (FI): Kjo pjesë përbën thelbin e Doracakut të M&V, pasi që përmban të gjitha informatat që mundësojnë mbledhjen e të dhënave për të gjithë indikatorët e SSSH-së. FI dëshmojnë ndërlidhjen dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve duke formalizuar mekanizmat dhe praktikat. Formulari i Indikatorit përmban këto elemente:
  - **Përkufizimin** - indikatori shpjegohet në hollësi, duke përfshirë arsyen e përzgjedhjes, mënyrën e përlogaritjes dhe në çfarë niveli analizohet;
  - **Parametrat që duhet matur** - renditen parametrat që duhet të mblidhen për ta matur indikatorin;
  - **Metodën e përzgjedhjes së mostrës** - shpjegohet metoda e përdorur, nëqoftëse nuk merren parasysh të gjitha njësitet për ta përcaktuar vlerën e indikatorit;
  - **Mbledhjen dhe analizën e të dhënave** - shpjegohet secili hap, duke dhënë hollësi se si, kush, dhe cilat të dhëna mblidhen, agregohen dhe analizohen.
  - **Periudhën dhe shpeshtësinë e mbledhjes së të dhënave** - përcaktohet periudha e vitit dhe shpeshtësia e mbledhjes së një indikatorit.
  - **Gjendjen fillestare** - paraqitet vlera fillestare e indikatorit, në momentin e krijimit të sistemit;
  - **Tabelat** - prezantim i formateve për mbledhjen, krahasimin, analizën dhe paraqitjen e të dhënave.
- Korniza logjike e SSSH 2017-2021 - Ky dokument është pjesë e SSSH 2017-2021 dhe përfshin logjikën e intervenimit, indikatorët, burimin e verifikimit, si dhe rreziqet dhe supozimet.

## 2.4. TERMINOLOGJIA E M&V DHE PËRKUFIZIMET

**Menaxhimi i Bazuar në Rezultate**- Sistemi i M&V e ka në themel qasjen e Menaxhimit të Bazuar në Rezultate (MRB). Kjo qasje përqendrohet te efektet dhe ndikimet e sjella nga zbatimi i SSSH-së, e jo te aktivitetet e realizuara. MBR-ja konsiderohet si alfabeti i sistemit të M&V i cili bazohet në zinxhirin e rezultateve, përkufizon hapat e çdo procesi që merret me burimet e dhëna, përdorimin e tyre për përfitimin e produkteve/shërbimeve në një mjedis të caktuar. Si pikë qendrore në MBR janë ndikimet aktuale të këtyre produkteve/shërbimeve në shoqëri, organizata dhe komunitete.



Figura 1 Qasja e Zinxhirit të Rezultateve



**Monitorimi** është mbledhja, analiza dhe përdorimi në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike e informatave me qëllim të përmirësimit të menaxhimit dhe performancës së shërbimeve në sektor si dhe ato ndërsektoriale. Procesi përqendrohet te indikatorët që masin outputet/ outcomet/ndikimet e arritura në vend të aktiviteteve të ndërmarra.

**Vlerësimi** është matja periodike e efektivitetit, efikasitetit, ndikimit, qëndrueshmërisë dhe relevancës, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit dhe performancës së shërbimeve në sektor si dhe ato ndërsektoriale.

*Janë paraparë dy vlerësime për SSSH-në: vlerësimi i ndërmjetëm (mesi i vitit 2019) dhe ai përfundimtar (2021). Çdo vlerësim përqendrohet në pesë kriteret më të shpeshta, si në vijim:*

- 1. Relevanca:** përshtatshmëria e objektivave të SSSH-së për problemet që ishte menduar të adresonte. Ajo duhet të përfshijë vlerësimin e cilësisë së përgatitjes dhe hartimit të SSSH-së;
- 2. Efektiviteti:** fakti nëse rezultatet e SSSH-së janë arritur me kosto të arsyeshme, d.m.th., se sa inputet/mjetet janë shndërruar në aktivitete në aspektin e cilësisë, sasisë dhe kohës. Ky kriter zakonisht kërkon krahasimin e qasjeve alternative për të parë se cili proces i miratuar ka qenë më efektiv;
- 3. Efikasiteti:** vlerësimi i kontributeve ndaj përbushjes së objektivës strategjike të SSSH-së, të dëshirueshme për të ndikuar në arritjet e SSSH-së. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin specifik të përfitimeve të siguruara nga grupet e synuara, duke përfshirë gratë, burrat dhe grupet e cenueshme të identifikuara;
- 4. Ndikimi:** ndikimi i SSSH-së në mjedisin më të gjerë, si gjendja shëndetësore e qytetarëve të Kosovës;
- 5. Qëndrueshmëria:** vlerësimi i përfitimeve të sjella nga SSSH-ja për të vazhduar rrjedhën pas përfundimit të financimit të SSSH-së. Vëmendje e veçantë i kushtohet pronësisë nga institucionet shëndetësore, mbështetjes politike, faktorëve ekonomikë dhe financiarë, aspekteve socio-kulturore, barazisë gjinore, teknologjisë së përshtatshme, aspekteve mjedisore, si dhe kapaciteteve institucionale dhe menaxheriale.

**Indikatorët** janë variabla të përdorura për ta matur përparimin drejt një synimi të dakorduar. Ata masin ndryshimet (përfitimet) dhe rezultatet e prodhuara nga aktivitetet e SSSH-së. Indikatorët mund të kategorizohen si në vijim:

- Indikatorët e **inputit** masin sasinë, llojin dhe disponueshmërinë e mjeteve dhe burimeve të planifikuara të SSSH-së.
- Indikatorët e **procesit** vlerësojnë performancën e disa aktiviteteve kyçe të realizuara nga SSSH-ja. Qëllimi është që të kontrollohet efektiviteti duke verifikuar nëse disa aktivitete kyçe drejtohen sipas standardeve të vendosura (p.sh., "Cilësia e një trajnimi të ofruar"). Ata po ashtu analizojnë se si janë përdorur inputet për të dhënë outpute. Indikatorët e këtij lloji njihen edhe si indikatorë të efektivitetit;
- Indikatorët e **outputeve** masin rrjedhojat e menjëhershme dhe konkrete të aktiviteteve të ndërmarra (p.sh., "numri i njerëzve të trajnuar");
- Indikatorët **outcome i ndërmjetëm** masin produktet ose shërbimet konkrete të siguruara përmes realizimit të aktiviteteve. Këto janë ndikimet e para të sjella nga përdorimi i produktit.
- Indikatorët **outcome final** masin ndryshimet në nivel të përfituesve parësorë (p.sh., "Shkalla e shfrytëzueshmërisë së shtretërve e rritur për 5% në vit"). Kjo arrihet kur të gjitha rezultatet



e planifikuara (outputet dhe outcome të ndërmjetëm) i ofrohen grupit të synuar/grupeve të synuara.

- Indikatorët e **ndikimit** (impaktit) masin rrjedhojat afatgjata të outcome për përfituesit përfundimtarë.
- Indikatorët e **përafërt** (proksi) nuk masin drejtpërdrejt rezultatet për shkak të mungesës së informatave apo qasjes së kufizuar në informata. Rrjedhimisht, ata zgjedhin një masë ose shenjë të tërthortë që i përafrohet apo e përfaqëson dukurinë.
- Indikatorët e **përbërë** (kompozit) ndihmojnë në matjen e efekteve të ndërlikuara që mund të mos pasqyrohen përmes një indikatori të vetëm. Ata përbëhen nga nën-indikatorë që vlerësojnë dimensione të ndryshme të ndryshimit. Indikatorët e përbërë janë po ashtu indikatorë të përafërt, meqë ajo çfarë pasqyrojnë ata nuk është matje e drejtpërdrejtë e ndryshimit, por një pasqyrim i tërthortë i gjendjes.

**Figura 2 Dallimi në mes të indikatorëve output dhe outcome**

INDIKATORËT OUTPUT	INDIKATORËT OUTCOME
Pasqyrojnë një produkt ose shërbim të ri të sjellë nga intervenimet. Nuk pasqyrojnë ndryshimet për përfituesit si rezultat i përdorimit të mallrave dhe shërbimeve.	Pasqyrojnë ndryshimet për përfituesit si rrjedhojë e përdorimit të mallrave dhe shërbimeve
Arrihen në aspektin afatshkurtër.	Arrihen në aspektin afatmesëm.
Nën kontrollin e plotë të menaxhimit të intervenimit.	Nuk janë plotësisht nën kontrollin e menaxhimit të intervenimit (u nënshtrohen faktorëve të jashtëm)
Prodhohen nga përdorimi i inputeve dhe realizimi i aktiviteteve.	Prodhohen nga ofrimi i outputeve (shërbimet dhe produktet).

Të gjithë indikatorët duhet të jenë **SMART**, një akronim ky i përdorur për të përmbledhur pesë kritere kyçe që duhet të respektohen gjatë formulimit të tyre: ata duhet të jenë specifike, të matshëm, të arritshëm, relevantë dhe me afate kohore të përcaktuara. Kjo do të thotë që indikatorët duhet të jenë të saktë (specifikë), të matshëm qoftë në mënyrë sasiore apo cilësore (të matshëm), duhet të synojnë një cak real dhe të arritshëm (të arritshëm), të pasqyrojnë siç duhet ndryshimet e pritura (relevantë) dhe për fund, vlerat e synuara duhet të ndërlidhen me afate kohore të përcaktuara qartë.

Për më tepër, të gjithë indikatorët duhet të jenë 'QQT', një akronim ky i përdorur për të përmbledhur tre elementet kryesore që duhet të përmbajë një indikator: Sasia, Cilësia dhe Koha. Këto elemente u përgjigjen pyetjeve: Sa? Çfarë? Kur?

**Përfituesit** janë individë, grupe njerëzish ose institucione që mund të kenë një ndërlidhje me SSSH-në. **Grupi i synuar** (ose përfituesit parësorë) është grupi/subjekti që do të ndikohet menjëherë dhe pozitivisht nga objektivat specifike të SSSH-së. **Përfituesit përfundimtarë** u referohen atyre që përfitojnë nga SSSH-ja në aspektin afatgjatë. Nga këndvështrimi i SSSH-së përfituesit përfundimtarë janë popullata e Kosovës që përfitojnë nga projekti në bazë afatgjatë.

### 3. SISTEMI I M&V

Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014 nuk parashihte ndonjë mekanizëm për monitorimin e realizimit të saj, prandaj nuk pati shumë mësim të nxjerra që mund të përdreshin gjatë zhvillimit të SSSH 2017-2021.

Ministria e Shëndetësisë në kuadër të Departamentit për zhvillim strategjik shëndetësor, ka krijuar për herë të parë Divizionin e M&V. SSSH-ja do të monitorohet nga një sistem i avancuar i M&V, me metodologji, mjete dhe instrumente të qarta për ta matur zbatimin e saj. MSh-ja me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve njerëzore, në vazhdimësi ka mbështetur proceset për të përmirësuar punën dhe menaxhimin strategjik, ku si rrjedhojë ka përfshirë stafin e saj në trajnime dhe punëtori të ndryshme, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë vendit.

Për Strategjinë e tanishme, MSh-ja ka miratuar qasjen e Menaxhimit të Bazuar në Rezultate. SSSH-ja përfshin kornizën logjike me indikatorë për secilën objektivë strategjike, specifike si dhe rezultat e pritura.

#### Qëllimet

*Qëllimet e sistemit të M&V të SSSH-së janë:*

- T'i ofrojë informata Ministrisë së Shëndetësisë dhe hisedarëve tjerë, lidhur me përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të SSSH-së, me qëllim që të mundësojë politikëbërjen e bazuar në dëshmi, ndihmojë vendimmarrjen si dhe ndërmarrjen e masave të duhura sipas nevojës;
- Të harmonizojë, standardizojë dhe thjeshtësojë procedurat e mbledhjes, agregimit dhe shpërndarjes së të dhënave ndërmjet institucioneve shëndetësore;
- Të rrisë ndërgjegjësimin dhe përdorimin e qasjes së monitorimit dhe vlerësimit në sektor;
- Të forcojë rolin drejtues të Ministrisë së Shëndetësisë në sektor si vendimmarrëse dhe udhëheqëse e strategjisë.

#### 3.1. KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INDIKATORËVE

*Indikatorët e propozuar në këtë Doracak janë përzgjedhur në bazë të katër kriterëve të mëposhtme:*

- 1. Kriteret 'Q.Q.T':** Sipas udhëzimeve ndërkombëtare lidhur me M&V, indikatorët duhet gjithmonë të jenë specifike në mënyrë adekuate sa u përket informatave mbi Sasinë, Cilësinë dhe Kohën.
- 2. Kriteret 'S.M.A.R.T':** Sipas udhëzimeve ndërkombëtare lidhur me M&V, indikatorët duhet gjithmonë të jenë të saktë (specifikë), të matshëm qoftë në mënyrë sasiore apo cilësore (të matshëm), duhet të kenë cak real dhe të arritshëm (të arritshëm), duhet të pasqyrojnë në mënyrë adekuate ndryshimet e pritura (relevantë) dhe për fund, vlerat e synuara duhet të ndërlidhen me afate kohore të përcaktuara qartë (me afate kohore të përcaktuara).
- 3. Shmangia e përsëritjeve dhe sistemit paralel për mbledhjen e të dhënave nga institucionet respektive:** Gjatë përzgjedhjes së indikatorëve u morën parasysh indikatorët që tashmë ishin mbledhur nga institucionet e tjera shëndetësore të sektorit. Në fakt, në nivel të spitaleve dhe atë kombëtar, mbledhen shumë indikatorë për të monitoruar performancën e sektorit në baza të rregullta. Sistemi i M&V të SSSH-së ka përzgjedhur prej tyre indikatorët më të përshtatshëm për rezultatet dhe objektivat specifike të saj.



4. Larmia e tipologjive të indikatorëve: Sistemi i M&V të projektit përpiqet të identifikojë indikatorë të llojeve të ndryshme, të tillë si indikatorët e procesit, outputeve kyçe, outcome të ndërmjetëm dhe outcome final.

### 3.2. ANALIZA TEKNIKE E INDIKATORËVE

Indikatorët janë klasifikuar sipas "Qasjes së Zinxhirit të Rezultateve". Rrjedhimisht, ata janë kategorizuar në tre grupe të ndryshme:

- Indikatorët output: kanë të bëjnë me përfitimet e para që rezultojnë nga përdorimi i produkteve dhe shërbimeve të ofruara
- Indikatorët outcome të ndërmjetëm: kanë të bëjnë me produktet ose shërbimet konkrete të siguruar përmes realizimit të aktiviteteve
- Indikatorët outcome final
- Indikatorët e ndikimit: kanë të bëjnë me përfitimet e fundit të siguruar nga përfituesit e drejtpërdrejtë.

**Figura 3 Përshkrimi i secilit indikator**

Nr.	Indikator	Lloji	Arsyetimi
1	Jetëgjatësia e pritshme e rritur në 72 vjet	NDIKIMI	Pasqyron shkallën e përgjithshme të vdekshmërisë së popullsisë
2	Pirja e duhanit bie për 3.5% në popullatën e përgjithshme	OUTCOME FINAL	Pirja e duhanit është një prej faktorëve kryesorë të rrezikut për sëmundjet kronike, i cili është i ndryshueshëm
3	Raporti vjetor i KShM-së i dorëzuar në MSh duke filluar nga fundi i vitit 2017	OUTPUT	Pasqyrë e aktiviteteve të KShM-së
4	200 trajnime për konceptin e shkollave promovuese të mbajtura	OUTPUT	Për të arritur stil të shëndetshëm jetese të rinjtë
5	Mortaliteti perinatal i zbritur nën 10‰	OUTCOME FINAL	Pasqyron statusin shëndetësor dhe ushqyes të nënës, si dhe cilësinë e kujdesit obstetrik dhe pediatrik
6	Mortaliteti infantil i zbritur nën 10‰	OUTCOME FINAL	Pasqyron kujdesin dhe kulturën shëndetësore antenatale, natale dhe postnatale
7	Shkalla e përfshirjes në vaksinim të rregullt e rritur në 95% (0-12 muaj)	OUTCOME FINAL	Është masa më e mirë, më e lirë dhe më e efikase për parandalimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë nga sëmundjet ngjithëse

Nr.	Indikatori	Lloji	Arsyetimi
8	Njësia referente diagnostikuese për HIV/ AIDS në IKShPK, për matjen e VL-së dhe gjenotipizimin e HIV-it, e themeluar	OUTPUT	Për të rritur efektivitetin e kostos së analizës që ndërlidhet me HIV/ AIDS-in
9	Incidenca e rasteve me TB ulet në 36/100,000 me trend epidemiologjik prej 3.5% në vit	OUTCOME FINAL	Për të zvogëluar shkallën e lartë të infektimit me TB
10	100% shitje e antibiotikëve me recetë të mjekut	OUTCOME I NDËRMJETMË	Kjo përbën njërin prej faktorëve kryesorë të keqpërdorimit të antibiotikëve dhe rezulton në prevalencë të lartë të rezistencës antimikrobiale
11	Niveli i zbatimit të higjienës së duarve rritet në 65%	OUTCOME FINAL	Është masa më e thjeshtë, më e mirë dhe më e lirë për parandalimin e infeksioneve në kujdesin shëndetësor
12	Përfshirja e 80% të nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta në edukim dhe promovim shëndetësor rreth sjelljeve të rrezikshme dhe faktorëve të rrezikut	OUTPUT	Është mjet thelbësor i edukimit dhe promovimit shëndetësor për formimin e shprehive pozitive të nxënësit
13	Strategjia për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve kronike jo-ngjyterëse e aprovuar nga MSh	OUTPUT	Përbën një mjet të fuqishëm në parandalimin dhe modifikimin e rrezikut nga sëmundjet jo-ngjyterëse
14	Vlerësimi i ndikimit të faktorëve mjedisor në shëndet i realizuar deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të mundësuar ndërhyrjet strategjike të bazuara në dëshmi për përmirësimin e faktorëve mjedisorë në shëndet
15	Strategjia dhe plani i veprimit për shëndet mendor i reviduar deri në fund të vitit 2018 nga MSh	OUTPUT	Për të zhvilluar Planin e Veprimit për zhvillimin e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore në shëndetin mendor
16	Komiteti shtetëror për shëndetin mjedisor funksional deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të siguruar që KShM të realizojë detyrat e tij kryesore
17	Eliminimi i rasteve të helmimit me plumb	OUTCOME I NDËRMJETMË	Për të adresuar një prej problemeve kryesore specifike për shëndetin e grupeve të cenueshme





Nr.	Indikatori	Lloji	Arsyetimi
18	Përqindja e qytetarëve që nuk kanë qasje në shërbime shëndetësore themelore për shkaqe ekonomike ulet për 5%	OUTCOME FINAL	Ky indikator nuk matet
19	Shërbimet nga lista themelore e kujdesit shëndetësor ofrohen nga Institucionet shëndetësore bazuar në kontratat e nënshkruara	OUTPUT	Kontraktimi i shërbimeve të listës themelore përmirëson cilësinë, racionalizon ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve, rrit përgjegjësinë e institucioneve shëndetësore dhe racionalizon përdorimin e mjeteve financiare
20	Premiumet e mbledhura nga të gjithë punonjësit në institucionet publike deri në fund të vitit 2018	OUTCOME FINAL	Për të siguruar mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve shëndetësore që nevojiten për shërbimet e listës themelore
21	Premiumet e mbledhura nga 50% e punonjësve në sektorin privat (me TVSh) duke filluar nga viti 2018, përqindje kjo që rritet për 15% çdo vit	OUTCOME FINAL	Për të siguruar mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve shëndetësore që nevojiten për shërbimet e listës themelore
22	Furnizim i plotë me barna dhe materiale shpenzuese nga lista esenciale në të gjitha institucionet publike shëndetësore	OUTPUT	Furnizimi i plotë me barna dhe materiale shpenzuese ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve shëndetësore
23	Premiumet e mbledhura nga 50% e popullatës për sigurimin shëndetësor të detyrueshëm	OUTCOME FINAL	Për të siguruar mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve shëndetësore që nevojiten për shërbimet e listës themelore
24	Lista e kujdesit themelor shëndetësor e aprovuar në baza vjetore duke filluar nga viti 2018 nga Qeveria	OUTPUT	Për të përkufizuar shërbimet që mbulohen nga sigurimi shëndetësor dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të FSSH-së
25	Përqindja e qytetarëve që nuk kanë qasje në shërbime shëndetësore themelore për shkaqe ekonomike ulet për 5%	OUTCOME FINAL	Ky indikator nuk matet



Nr.	Indikatori	Lloji	Arsyetime
26	Kontratat e shërbimit ndërmjet AFSH-së dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore nga pakoja bazike nënshkruhen me të gjitha institucionet publike në baza vjetore	OUTPUT	Për të përmirësuar cilësinë, racionalizuar ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve, rritur përgjegjësinë e institucioneve shëndetësore parësore, dytësore dhe tretësore, si dhe për të racionalizuar përdorimin e mjeteve financiare
27	Shkalla e shfrytëzueshmërisë së shtretërve rritet për 5% në vit	OUTCOME	Është e rëndësishme të matet cilësia, efektiviteti i kostos dhe performanca e institucioneve shëndetësore
28	Të gjitha pozitat e plotësuara bazuar në rregulloren e brendshme të MSh-së deri në fund të vitit 2018	OUTCOME I NDËRMJETËM	Për të matur nivelin e zbatimit të planit të ri organizativ të Ministrisë
29	Komiteti i themeluar deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Ky indikator nuk matet
30	Plani i MSh-së për burimet njerëzore dhe zhvillimin i hartuar	OUTPUT	Për të planifikuar nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, shpërndarjen adekuate dhe rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve
31	Plani i trajnimeve të stafit të MSh-së bazuar në përshkrimin e vendeve të punës, i përpiluar në vitin 2018 dhe i përditësuar në baza vjetore	OUTPUT	Për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e stafit të MSh-së për përmbushjen e objektivave të vendit të punës
32	Harmonizimi i indikatorëve të projekteve nga donatorët me indikatorët e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë	OUTCOME I NDËRMJETMË	Për të orientuar investimin e partnerëve zhvillimorë bazuar në objektivat strategjike të sektorit
33	Matrica e M&V së SSSH-së e përpiluar dhe e përditësuar çdo 6 muaj duke filluar nga viti 2018	OUTPUT	Për të siguruar monitorimin efektiv të SSSH-së
34	Të gjitha detyrat e OPSH-ve përmbushen sipas 14 kompetencave të përcaktuara me Ligj deri në fillim të vitit 2019	OUTCOME I NDËRMJETMË	Për të siguruar bartjen e detyrave nga MSh te odat e themeluara rishtazi
35	5 OPSH kanë zyrat dhe hapësirat permanente për funksionim deri në fillim të vitit 2018	OUTPUT	Për të pajisur OPSH-të e themeluara rishtazi me infrastrukturën e nevojshme



Nr.	Indikatori	Lloji	Arsyetimi
36	100% e stafit të administratës së OPSH-ve të punësuar në bazë të Ligjit për OPSH-të deri në fillim të vitit 2018	OUTPUT	Për të pajisur OPSH-të e themeluara rishtazi me shërbimet e nevojshme administrative duke përfshirë aspektet ligjore dhe financiare
37	Infrastruktura e zgjedhur ligjore për funksionalizimin e OPSH-ve e kompletuar deri në fillim të vitit 2018	OUTPUT	Infrastruktura ligjore është e nevojshme për realizimin e aktiviteteve të OPSH-ve
38	70% e aktiviteteve të zgjedhura sipas planit të realizuara çdo vit duke filluar nga viti 2018	OUTCOME FINAL	Është e rëndësishme të ketë një plan veprimi për të udhëhequr punën e odave të themeluara rishtazi (caktimi i aktiviteteve konkrete, zbatimi i politikave shëndetësore për profesionet përkatëse, rritja e cilësisë së shërbimeve profesionale
39	Procedurat e zgjedhura nga doracaku i veprimit të zbatuara në të gjitha njësitë spitalore të ShSKUK-së	OUTPUT	Për të rregulluar hollësisht funksionimin operativ të të gjitha njësive të ShSKUK-së
40	Statutet e 8 njësive spitalore të ShSKUK-së të aprovuara deri në vitin 2018 nga MSh	OUTPUT	Është thelbësore për shkak të ndryshimeve themelore të sistemit shëndetësor nga reforma sektoriale e shëndetësisë
41	36 inspektorë të rinj të punësuar në Inspektoratin Shëndetësor	OUTPUT	Për të mundësuar mbikëqyrje efektive në terren duke mbuluar gjithë sistemin shëndetësor të vendit
42	8 njësitë spitalore hartojnë planin vjetor të zhvillimit të vazhdueshëm profesional	OUTPUT	Për të përmirësuar në vazhdimësi cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe për të krijuar shërbime të reja
43	Shërbimet e pakos bazike të kontraktuara me secilën njësi të ShSKUK-së	OUTPUT	Për të përmirësuar cilësinë, racionalizuar ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve, rritur përgjegjësinë e institucioneve shëndetësore parësore, dytësore dhe tretësore, si dhe për të racionalizuar përdorimin e mjeteve financiare
44	80% e ekipeve të mjekësisë familjare kanë listat e tyre të pacientëve	OUTCOME	Për të zbatuar konceptin e Mjekësisë Familjare, i cili është gurthemeli i sistemit shëndetësor

Nr.	Indikatori	Lloji	Arsyetimi
45	250 mjekë familjarë të përfshirë në Shkollimin specialistik post-diplomik në mjekësi familjare (të plotësohet standardi 1 MF për 2000 banorë)	OUTPUT	Për të arritur standardin 1 mjek familjar për 2000 banorë
46	100% të menaxherëve të QKMF-ve të trajnuar për shkathtësi bazike menaxheriale	OUTPUT	Për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e burimeve financiare dhe njerëzore
47	Plani operativ për promovim të konceptit të mjekësisë familjare i përpiluar çdo vit duke filluar nga 2018	OUTPUT	Për të rritur vetëdijesimin e popullatës lidhur me konceptin e Mjekësisë Familjare
48	90% e institucioneve në KPSH janë të furnizuara me pajisjet bazike për shërbimet e MF	OUTPUT	Për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore në kujdesin parësor shëndetësor
49	90% e institucioneve në KPSH zbatojnë standardet e zgjedhura	OUTCOME I NDËRMJETMË	Për të matur efikasitetin dhe efektivitetin e ofruesve të kujdesit parësor shëndetësor dhe zbatimin e procedurave klinike nga ana e profesionistëve shëndetësorë
50	20 UPK të aprovuara dhe shpërndara në të gjitha institucionet e KPSH deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të përmirësuar në vazhdimësi cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore duke zbatuar praktikën më të mirë mjekësore të mjekësisë së bazuar në dëshmi
51	Të gjitha stacionet e SISH-it janë të arritshme për sistemin deri në fund të vitit 2018	OUTCOME I NDËRMJETMË	Për të përmirësuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e të dhënave, si dhe për të siguruar planifikim dhe vendimmarrje të bazuar në dëshmi
52	Të gjitha institucionet shëndetësore publike në të gjitha nivelet e kujdesit të pajisura me TI deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të përmirësuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e të dhënave, si dhe për të siguruar planifikim dhe vendimmarrje të bazuar në dëshmi
53	Të gjitha IPSH-të në të gjitha nivelet e kujdesit të pajisura me softuer të SISH-it deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të përmirësuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e të dhënave, si dhe për të siguruar planifikim dhe vendimmarrje të bazuar në dëshmi




Nr.	Indikatori	Lloji	Arsyetimi
54	5 akte nënligjore për SISh të aprovuara nga MSh	OUTPUT	Për të rregulluar funksionimin e SISh-it bazuar në kërkesat ligjore që burojnë nga strategjia e SISh-it
55	Kontrata trevjeçare me operatorët ekonomik për mirëmbajtje të SISh e përtërirë nga MSh	OUTPUT	Ky indikator nuk matet
56	100% e operatorëve të trajnuar për SISh	OUTPUT	Për t'u mundësuar operatorëve shëndetësorë ta përdorin SISh-in
57	50 tregues shëndetësorë raportohen në EUROSTAT	OUTCOME	Për të harmonizuar dhe krahasuar indikatorët me shtetet anëtare të BE-së
58	100% e institucioneve të KDSH dhe KTSH ofrojnë shërbime bazuar në UPK-të e aprovuara	OUTPUT	Për të përmirësuar në vazhdimësi cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore duke zbatuar praktikën më të mirë mjekësore të mjekësisë së bazuar në dëshmi
59	80% e institucioneve të nivelit dytësor dhe tretësor zbatojnë standardet e zgjedhura deri në fund të vitit 2018	OUTCOME	Për të siguruar funksionimin efektiv dhe fikas të institucioneve të KDSH-së dhe KTSH-së, si dhe zbatimin e procedurave shëndetësore nga ana e profesionistëve shëndetësor
60	Plani kombëtar për akreditim i aprovuar deri në fund të 2019	OUTPUT	Për të përcaktuar rregullat dhe mjetet e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore si një proces i rëndësishëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të cilësisë së lartë
61	Standardi i OBSH-së për shkallën e infeksioneve spitalore në ShSKUK i arritur	OUTCOME	Për të zvogëluar komplikimet gjatë trajtimit mjekësor, për të zvogëluar gjatësinë e qëndrimit dhe për të rritur efektivitetin e kostos
62	Udhëzimi Administrativ për sistemin e referimit i aprovuar deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të shmangur mbingarkimin e niveleve të kujdesit dytësor dhe tretësor nga vetë-referimi, si dhe për të rritur efektivitetin e kostos dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore

Nr.	Indikatori	Lloji	Arsyetimi
63	Programet e skringut për kancerin e gjirit, kancerin cervical dhe kancerin kolorektal të aprovuara nga MSh deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Parandalimi është baza e kontrollimit të kancerit. Kanceri i gjirit, kanceri cervical dhe kanceri kolorektal janë llojet më të përhapura të kancerit në Kosovë
64	Kirurgjia pediatrike dhe Klinika e re e Emergjencës në ShSKUK të themeluara deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore
65	Softueri për inventarizimin e pajisjeve në Ish përditësohet duke shtuar pajisjet mjekësore deri në fund të vitit 2018	OUTPUT	Për të ofruar dëshmi të sakta mbi gjendjen e institucioneve në aspektin e pajisjeve, vlerësimin, planifikimit dhe menaxhimit më të lehtë
66	Ngritja e nivelit të furnizimit me produkte mjekësore të institucioneve shëndetësore parësore në 95% nga lista esenciale	OUTPUT	Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimin e konceptit të Mjekësisë Familjare

Nga 66 indikatorët e përfshirë në kornizën logjike, janë zhvilluar 62 FI, ndërsa 4 janë lënë jashtë, për shkak se këta indikatorë nuk janë më relevant, meqenëse MSh ka zgjedhur një modalitet tjetër zbatimi për rezultatet përkatëse.

Përqindja e nivelit të indikatorëve është paraqitur në diagramin e mëposhtëm:

**Figura 4 Përqindja e llojit të indikatorëve në SSSH**





Siç paraqet diagrami, 42 nga gjithsej numri i indikatorëve të përzgjedhur janë indikatorë të outputit (68%). Ata korrespondojnë me nivelin e rezultateve, ndërsa indikatorët outcome i ndërmjetëm dhe outcome final janë gjithsej 19 (12+7) (30%) dhe korrespondojnë me objektivat specifike në kornizën ligjore të SSSH-së. Vetëm një indikator mat ndikimin e përgjithshëm të Strategjisë sektoriale në shëndetin e përfituesve përfundimtarë.

### 3.3. PËRSHKRIMI I SISTEMIT TË M&V

Sistemi i M&V të SSSH-së përfshin dy nivele, atë qendror dhe lokal.

**Niveli qendror:** duke pasur parasysh ndikimin e SSSH-së në tërë sistemin shëndetësor, sistemi i M&V ka për qëllim monitorimin dhe vlerësimin e të dhënave shtetërore. Institucionet e përfshira në sistemin e M&V janë Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës si dhe Institucionet tjera të përcaktuara me Ligjin e Shëndetësisë.

**Niveli lokal:** sistemi i M&V të SSSH-së ka për qëllim monitorimin dhe vlerësimin e të dhënave në nivelin komunal, prandaj shumë indikatorë disagregohen për komunat relevante. Për shembull, përfshirja e mjekëve familjarë matet në nivelin lokal, pasi që kjo gjë bazohet në të gjitha institucionet shëndetësore në nivel komunal.

*Për secilin indikator, sistemi i M&V realizohet në katër (4) faza. Në çdo Formular të Indikatorit duhet të përkufizohen këto faza:*

1. **Mbledhja e të dhënave** është mbledhja e informatave në terren ose nga burimi respektiv.
2. **Agregimi i të dhënave** është grumbullimi i informatave me qëllim të përfitimit të një numri të kuptueshëm dhe të përkufizuar i informatave.
3. **Analiza e të dhënave** përfshin shpjegimin, komentimin dhe interpretimin e të dhënave dhe dukurive prapa të dhënave. Në këtë fazë, ekspertët dhe profesionistët vendor nga institucionet e përfshira mund të intervistohen për të analizuar të dhënat, sipas nevojës.
4. **Prezantimi i të dhënave** është veprimi në formatin e nevojshëm, siç parashihet në Formularët e Indikatorëve dhe në përputhje me mënyrën e komunikimit të zgjedhur për raportim (grafikët, figurat, teksti).

Për secilin indikator në Formularët e Indikatorëve, për këto katër faza, është caktuar një institucion/departament/divizion si përgjegjës për detyrën.

### 3.4. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E M&V

Më poshtë janë renditur organet/njerëzit që luajnë një rol në zbatimin e sistemit të M&V të SSSH-së.

**Sekretari i Përgjithshëm** është Zyrtar kryesor administrativ në MSh, përgjegjës për miratimin e Doracakut dhe të Raportit Vjetor të M&V.

**Grupi këshillëdhënës për M&V** themelohet me vendim të ZSP, dhe ka përgjegjësi për matjen e formularëve të indikatorëve të përcaktuar në SSSH bazuar në raportet e gjeneruara nga Divizioni për M&V, si dhe detyrave tjera të përcaktuara me vendim. Grupi ofron rekomandime bazuar në të gjeturat e raportit të Divizionit.

**Grupi teknik për M&V** të SSSH-së e mbështet punën e Divizionit për M&V. Grupi teknik është grup pune në të cilin akterët sjellin informatat e tyre dhe bëjnë analiza të përbashkëta. Grupi teknik do të takohet dy herë në vit. Takimi i parë do të mbahet në tetor dhe do të analizojë indikatorët e mbledhur nga janari deri në qershor. Takimi i dytë do të mbahet në prill dhe do të analizojë indikatorët e mbledhur nga korriku deri në dhjetor. Gjatë takimit të dytë, Grupi Teknik i M&V do të japë rekomandime.

Takimet e grupit do të organizohen nga Divizioni i M&V i DZHSSH të MSh-së, i cili lehtëson takimet dhe siguron bazën e të dhënave të M&V, ku do të ruhen të gjitha tabelat dhe vlerat e indikatorëve.

Divizioni i M&V integron informatat nga burimet relevante dhe përgatit raportin bazuar në informatat e grumbulluara nga institucionet gjegjëse si dhe mbledh dhe sintetizon informatat që vijnë në formate të ndryshme, që përdorin terminologji të ndryshme dhe mbulojnë fusha të ndryshme, për të krijuar një analizë uniforme dhe konsistente.

IKShP-ja do të jetë anëtar kyç i Grupit Teknik të M&V. Është e rëndësishme që informatat e disponueshme nga ky institucion të shfrytëzohen plotësisht dhe të shmangen dyfishimet e përpjekjeve.

#### • **Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor**

Regullorja (QRK) Nr. 07/2015 Për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Shëndetësisë e përcakton strukturën, përgjegjësinë dhe hierarkinë e Ministrisë së Shëndetësisë, përfshirë Departamentin për Zhvillim Strategjik Shëndetësor, në kuadër të të cilit është edhe Divizioni i Monitorimit dhe Vlerësimit.

#### ■ **Divizioni i M&V**

Divizioni i M&V është pjesë e Departamentit për Zhvillim Strategjik që udhëhiqet nga Udhëheqësi i DZHSSH-së. Bazuar në Rregulloren aktuale, Divizioni parasheh tre zyrtarë.

*Bazuar në Rregulloren (QRK) nr. 07/2015 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Shëndetësisë, detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Monitorimit dhe Vlerësimit janë:*

- 1.** Grumbullimi dhe analizimi i të gjitha raporteve monitoruese dhe vlerësuese vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave/strategjive dhe legjislacionit në fuqi në fushën e shëndetësisë;
- 2.** Përcjellja e indikatorëve kryesorë të shëndetit, vlerësimi i përmbushjes së tyre në aspektin e kosto/efektivitetit të shërbimeve dhe harton raporte periodike;
- 3.** Koordinimi i aktiviteteteve me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, Entin Statistikor të Kosovës, Agjensionin e Financimit të Shëndetësisë dhe palët relevante kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 4.** Udhëheqësi i Divizionit të Monitorimit dhe Vlerësimit raporton tek Udhëheqësi i Departamentit.



Divizioni i M&V është përgjegjës për zbatimin e sistemit të M&V të SSSH-së, më saktësisht i ka edhe këto detyra:

1. Ta kryesojë Grupin teknik të M&V në përpilimin e Raportit Vjetor të M&V
2. Të hartojë Doracakun e M&V, duke përfshirë Matricën dhe MMVRr-në;
3. Të hartojë FI-të në bashkëpunim me institucionet shëndetësore;
4. Të zhvillojë Planin e Punës për M&V;
5. Të koordinojë aktivitetet e M&V me akterët kryesorë shëndetësorë.


#### ■ Akterët shëndetësorë dhe Departamentet e MSh-së

Të gjithë akterët e përfshirë në sistemin e M&V, përveç atyre të përmendur më lartë, janë departamente dhe institucione në sektorin shëndetësor. Ata bashkëpunojnë me qëllim të zbatimit të suksesshëm të sistemit duke i siguruar të dhëna Divizionit të M&V. Më saktësisht, ata janë të përfshirë në hartimin e Formularëve të Indikatorëve dhe janë pjesë e rrjedhës së informatave nga burimi të Divizionit të M&V. Me fjalë të tjera, ata marrin pjesë në:

1. Mbledhjen e të dhënave
2. Agregimin e të dhënave
3. Analizën e të dhënave

Më poshtë është dhënë skema e strukturës së M&V.

**Figura 5 Hierarkia në sistemin e M&V**






### 3.5 MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Mbledhja e të dhënave kryesisht bëhet nga ShSKUK, IKShP, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor, Sistemi Operativ Kombëtar për SISH, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.

Diagrami në vijim paraqet akterët shëndetësorë përgjegjës për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas departamenteve.

**Figura 6 Numri i indikatorëve të mbledhur nga akterët shëndetësorë**




Si përfundim i qartë është që zbatimi i suksesshëm i sistemit të M&V sigurohet, para së gjithash, me anë të bashkëpunimit të mirë ndërmjet institucioneve shëndetësore, që janë përgjegjësit kryesorë për mbledhjen e të dhënave. Në fakt, mbledhja e të dhënave përbën hapin e parë dhe thelbësor për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të SSSH-së.

Diagrami i mëposhtëm paraqet institucionet përgjegjëse.



**Figura 7 Institucionet e përfshira në mbledhjen e të dhënave**




### 3.6 AGREGIMI I TË DHËNAVE

Pas mbledhjes së të dhënave, Matrica e M&V përcakton institucionet përgjegjëse për agregimin e të dhënave, sikundër specifikohet në FI.


Diagrami në vijim paraqet akterët shëndetësorë përgjegjës për agregimin e të dhënave të ndara sipas departamenteve.

**Figura 8 Numri i indikatorëve të agreguar nga akterët shëndetësorë**



Diagrami në vijim paraqet institucionet përgjegjëse.

**Figura 9 Institucionet përgjegjëse për agregimin e të dhënave**




### 3.7 ANALIZA E TË DHËNAVE

Sa i përket analizës së të dhënave, Divizioni i M&V i Ministrisë mbulon 30% të indikatorëve. Në rastet e tjera, institucionet e tjera shëndetësore thirren të analizojnë masat, para së gjithash Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Diagrami në fillim paraqet akterët e disagreguar shëndetësorë përgjegjës për analizën e të dhënave.


**Figura 10 Numri i indikatorëve të analizuar nga akterët shëndetësorë**





Diagrami në vijim paraqet institucionet përgjegjëse.

**Figura 11 Institucionet përgjegjëse për analizën e të dhënave**



### 3.8 PËRMBLEDHJA TË DHËNAVE

Në tabelën e mëposhtme, aktiviteti i përmbledhjes së të dhënave për secilin indikator organizohet gjatë një periudhe njëvjeçare. Për çdo indikator Divizioni i M&V e ka kohën e saktë për përmbledhjen e të dhënave të marra nga institucionet e lartpërmendura që janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave.

Numrat në kolonën e parë korrespondojnë me indikatorët e SSSH-së (siç janë renditur në kornizën logjike të SSSH-së), ndërsa rubrikat e ngjyrosura tregojnë kohën e përmbledhjes.





INDIKATORI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
59												
60												
61												
62												
63												
64												
65												
66												

### 3.9 MATRICA

Matrica e M&V përmbledh informatat kyçe rreth matjes së zbatimit të SSSH-së në gjithë indikatorët. Ajo përditësohet çdo vit nga Grupi Punues i M&V dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MSh-së. Çdo vit, secila kolonë në "Cakun Vjetor" do të ndahet në dy, ku njëra përmban cakun e planifikuar dhe tjetra cakun e arritur.



N	Rezultati dhe indikatorët	Njësia	Gjendja fillestare	Vlera, shqyrtimi aktual	Vlera, periudha para-prake	Metoda e mbledhjes së të dhënave	Burimi i verifikimit	Frekuenca	Periudha	Institucioni përgjegjës			Pragu për vlerësimin e performancës		
										Mbledhja e të dhënave	Agregimi i të dhënave	Analiza e të dhënave	Gjelbër	Verdhë	Kuq
1	Jetëgjatësia e pritshme e rritur në 72 vjet	#	70 (2013)			Kontrolli i evi-dencave	Raporti Vjetor, IK-ShP	Çdo 5 vjet	/	ASK	ASK	IKShP			
1.1	Pirja e duhanit bie për 3.5% në popullatën e përgjithshme	%	28.4% (2011)			Sondazhi	Raporti i hulumtimit STEPs, IK-SHPK	Çdo 4 vjet	/	IKShP	IKShP – DSISH	IKShP	≥ 3.5%	3-3.49%	≤ 3%
1.1.1	Raporti vjetor i KESH-it i dorëzuar në MSh duke filluar nga fundi i vitit 2018	P/J	0			Kontrolli i evi-dencave	Raporti Vjetor, KESH	Një herë në vit	Java 1 e shkurtit	IKShP-KESH	IKShP – KESH	IKShP – KESH	Para javës 1 të shkurtit	Java 2 e shkurtit-qerorit	Pas 1 korrikut
1.1.2	200 trajnime për konceptin e shkollave promovuese të mbajtura	#	0			Kontrolli i evi-dencave	Raporti Vjetor, IK-SHPK	Dy herë në vit	Java 1 e korrikut dhe janarit	IKShP-KESH	IKShP-KESH	IKShP-KESH	≥ 32%	20-31%	< 20%
1.2	Mortaliteti perinatal i zbritur nën 10%	%	12% (2014)			Kontrolli i evi-dencave	Raporti vjetor, ASK	Një herë në vit	Java 2 e shtatorit	ASK	ASK – DTI	IKShP	< 10%	10-11%	> 11%
1.2.1	Mortaliteti i infantit i zbritur nën 10%	%	11.4% (2012)			Kontrolli i evi-dencave	Analiza e statusit shëndetësor, IKSHPK	Një herë në vit	Java 2 e shtatorit	ASK	ASK – DTI	IKShP	≤ 9.5%	9.6-10.5%	≥ 10.6%
1.3	Shkalla e përfshirjes në vaksinim të rregullt e rritur në 95% (0-12 muaj)	%	95.8% (2011-15)			Kontrolli i evi-dencave	Raporti Vjetor, IK-SHPK	Një herë në vit	Java 1 e shkurtit	IKShP	IKShP – DE	IKShP	≥ 95%	92-94%	≤ 91%
1.3.1	Njësia referente diagnostikuese për HIV/ AIDS në IKShPK, për matjen e VL-së dhe gjenotipizimin e HIV-it, e themeluar	P/J	0			Vrojtimi i drejt-përdrejtë	Raporti Vjetor, IK-SHPK	Mbledhja e njëhershme	Java 2 e janarit	IKShP	IKShP – DM	IKShP			
1.3.2	Incidenca e rasteve me TB ulet në 36/100,000 me trend epidemiologjik prej 3.5% në vit	%	46/100,000			Kontrolli i evi-dencave	Raporti nga Zyra për TB, MSh	Një herë në vit	Java 1 e majit	IKShP	IKShP – DE	IKShP, MSh – Zyra për TB	< 30%	30-36%	> 36%



N	Rezultati dhe indikatorët	Njësia	Gjendja fillestare	Vlera, shqyrtimi aktual	Vlera, periudha para-prake	Metoda e mbledhjes së të dhënave	Burimi i verifikimit	Frekuenca	Periudha	Institucioni përgjegjës			Pragu për vlerësimin e performancës		
										Mbledhja e të dhënave	Agregimi i të dhënave	Analiza e të dhënave	Gjelbër	Verdhë	Kuq
Infrastruktura ligjore është e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së odave të profesionistëve shëndetësorë. Në infrastrukturën ligjore përfshihet Ligji për OPSH-të, si akti më i lartë ligjor, nga i cili derivojnë edhe aktet tjera nënligjore.

*Aktet nënligjore të zgjedhura përfshijnë:*

1. Statutet e secilës odë të aprovuara nga Ministri i Shëndetësisë,
2. Kodi etik i odës përkatëse, aprovuar nga Ministri i Shëndetësisë,
3. Rregullorja e punës së Kuvendit të odës,
4. Rregullorja e punës së Këshillit drejtues,
5. Rregullorja e punës së Këshillit etik,
6. Rregullorja e punës së Këshillit mbikëqyrës,
7. Rregullorja e punës së Gjyqit të nderit,
8. Rregullorja e punës së Prokurorit,
9. Rregullorja e punës së Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional (KEVP),
10. Rregullorja e punës së Komisionit për çështje etike,
11. Rregullorja e punës së Komisionit për specializim,
12. Rregullorja e punës së Komisionit për licencim dhe rilicencim,
13. Rregullorja e punës së Komisionit për praktikën private profesionale,
14. Rregullorja e punës së Komisionit për buxhet dhe financa, dhe
15. Rregullorja e punës së Komisionit për solidaritet.

Ky indikator disagregohet në bazë të odave.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat kryesor që duhen matur janë:*

- Numri i akteve nënligjore të aprovuara nga Kuvendi i odës përkatëse.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për matjen e indikatorit nuk përdoren metoda të përzgjedhjes së mostrës, pasi që të gjithë të dhënat merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikator.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave



- Hapi 1:** Kuvendi i odës përkatëse, në mbledhjen e vet të rregullt, aprovon aktin e caktuar ligjor.
- Hapi 2:** Kryetari i secilës odë (kontakt personi) bën mbledhjen e të dhënave për odën përkatëse dhe i prezanton në tabelën 1.
- Hapi 3:** Kontakt personat nga odat përkatëse dërgojnë në mënyrë elektronike tabelën 1 të plotësuar tek Udhëheqësi i Divizionit të M&V-së në MSh.
- Hapi 4:** Udhëheqësi i Divizionit të M&V-së bën agregimin e të dhënave nga të gjitha odat dhe sekretaria e përbashkët në tabelën 2.
- Hapi 5:** Vlera e këtij treguesi dhe një analizë e shkurtër e trendeve bëhet nga Divizioni i M&V-së dhe prezantohet në raportin vjetor të M&V-së duke përdorur tabelën 3.

### e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të dhënave

Java e tretë e dhjetorit, në baza vjetore.

### f) Niveli fillestar

Të dhënat për nivelin fillestar janë të paraqitura në tabelën 4.

### 3.2.3 - Tabela 1. Statusi i infrastrukturës ligjore.

Nr.	Akti nënligjor	Statusi
1	Statuti i odës i aprovuar nga Ministri i shëndetësisë	
2	Kodi etik i odës, aprovuar nga Ministri i shëndetësisë	
3	Rregullorja e punës së Kuvendit të odës	
4	Rregullorja e punës së Këshillit drejtues	
5	Rregullorja e punës së Këshillit etik	
6	Rregullorja e punës së Këshillit mbikëqyrës	
7	Rregullorja e punës së Gjyqit të nderit	
8	Rregullorja e punës së Prokurorit	
9	Rregullorja e punës së Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional (KEVP)	
10	Rregullorja e punës së Komisionit për çështje etike	
11	Rregullorja e punës së Komisionit për specializim	
12	Rregullorja e punës së Komisionit për licencim dhe rilicencim	
13	Rregullorja e punës së Komisionit për praktikën private profesionale	
14	Rregullorja e punës së Komisionit për buxhet dhe financa	
15	Rregullorja e punës së Komisionit për solidaritet	

**3.2.3 - Tabela 2. Agregimi i statusit të infrastrukturës ligjore.**

Nr.	Akti nënljor	OFK	OSK	OMK	OIK	OFTK
1	Statuti i odës i aprovuar nga Ministri i shëndetësisë					
2	Kodi etik i odës, aprovuar nga Ministri i shëndetësisë					
3	Rregullorja e punës së Kuvendit të odës					
4	Rregullorja e punës së Këshillit drejtues					
5	Rregullorja e punës së Këshillit etik					
6	Rregullorja e punës së Këshillit mbikëqyrës					
7	Rregullorja e punës së Gjyqit të nderit					
8	Rregullorja e punës së Prokurorit					
9	Rregullorja e punës së Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional (KEVP)					
10	Rregullorja e punës së Komisionit për çështje etike					
11	Rregullorja e punës së Komisionit për specializim					
12	Rregullorja e punës së Komisionit për licencim dhe rilicencim					
13	Rregullorja e punës së Komisionit për praktikën private profesionale					
14	Rregullorja e punës së Komisionit për buxhet dhe financa					
15	Rregullorja e punës së Komisionit për solidaritet					

**3.2.3 - Tabela 3. Prezantimi i infrastrukturës ligjore të odave.**

Nr.	Oda	Numri i akteve të aprovuara	%
1	OFTK		
2	OFK		
3	OIK		
4	OSK		
5	OMK		



### 3.2.3 - Tabela 4. Të dhënat fillestare (Janar 2017).

Nr.	Akti nënligjor	OFK	OSK	OMK	OIK	OFTK
1	Statuti i odës i aprovuar nga Ministri i shëndetësisë	X	X	X	X	X
2	Kodi etik i odës, aprovuar nga Ministri i shëndetësisë	X	X	X	X	X
3	Rregullorja e punës së Kuvendit të odës	X	X	X	X	X
4	Rregullorja e punës së Këshillit drejtues	X	X	X	X	X
5	Rregullorja e punës së Këshillit etik	X	X	X	X	X
6	Rregullorja e punës së Këshillit mbikëqyrës	X	X	X	X	X
7	Rregullorja e punës së Gjyqit të nderit	X		X	X	
8	Rregullorja e punës së Prokurorit	X			X	
9	Rregullorja e punës së Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional (KEVP)	X	X	X	X	X
10	Rregullorja e punës së Komisionit për çështje etike	X		X	X	X
11	Rregullorja e punës së Komisionit për specializim	X				
12	Rregullorja e punës së Komisionit për licencim dhe rilicencim	X	X	X	X	X
13	Rregullorja e punës së Komisionit për praktikën private profesionale	X			X	
14	Rregullorja e punës së Komisionit për buxhet dhe financa	X	X	X	X	X
15	Rregullorja e punës së Komisionit për solidaritet	X			X	

### 3.2.4 70% E AKTIVITETEVE TË ZGJEDHURA SIPAS PLANIT TË ODAVE TË REALIZUARA ÇDO VIT DUKE FILLUAR NGA VITI 2018

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Indikatorin matë nëse plani i veprimit, dokumenti në të cilin bazohet puna njëvjeçare e odës përkatëse, është implementuar nga viti 2017 (OSK, OMK, OFK, OFTK, OIK). Planin e veprimit përpilohet nga Kryetari i odës, dhe aprovohet nga Kuvendi i odës përkatëse deri në fund të dhjetorit të vitit paraprak. Në këtë plan paraqiten aktivitetet të cilat do të zhvillohen nga oda, në përputhje me nevojat profesionale dhe mundësitë buxhetore.

*Pasi që odat janë institucione të reja, është e rëndësishme që secila odë të ketë planin e vet të veprimit, si dokument udhëheqës në punën e odës. Planin e veprimit merr parasysh këto aspekte:*

- Përcaktimi i aktiviteteve të organeve të odës sipas specifikave të tyre,
- Pjesëmarrja në implementimin e politikave shëndetësore për profesionin përkatës,
- Përfaqësimi i denjë i profesionit në vend dhe jashtë tij,
- Organizimi dhe menaxhimi i edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), licencimi dhe rilicencimi, specializimet dhe zbatimi i kodit etik, me qëllim të ngritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve profesionale.

Formati i planit të veprimit është i paraqitur në tabelën 1.

Në fund të vitit, Kryetari i odës përkatëse do të prezantojë në Kuvendin e odës punën njëvjeçare të odës. Kuvendi aprovon planin e prezantuar nga Kryetari i odës, ku paraqiten aktivitetet e implementuara dhe të pa implementuara nga plani i veprimit për atë vit. Raportimi mbi implementimin e planit të veprimit do të paraqitet sipas tabelës 2.

*Formula e llogaritjes së shkallës së implementimit është:*

$\% \text{ e implementimit} = (\# \text{ Aktiviteteve të implementuara} / \# \text{ i aktiviteteve totale}) * 100.$

Një aktivitet do të konsiderohet si i implementuar nëse 80% nga sasia e planifikuar është realizuar.

Ky indikator do të disagregohet sipas odave.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat kryesor që duhen matur janë:*

- Numri i aktiviteteve nga plani i veprimit të implementuara;
- Numri total i aktiviteteve në planin e veprimit.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për matjen e indikatorit nuk përdoren metoda të përzgjedhjes së mostrës, pasi që të gjithë të dhënat merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikator.



**3.2.4 - Tabela 2. Implementimi i planit të veprimit të odës.**

Nr	Aktiviteti	Njësia matëse	Sasia e planifikuar	Sasia e realizuar	Afati kohor	Organi implementues	Buxheti	Statusi po >80% jo <80%
Objektiva # 1								

**3.2.4 - Tabela 3. Përqindja e implementimit të planeve të veprimit të odave.**

Odat e profesionistëve	OFTK	OIK	OFK	OMK	OSK
Numri total i aktiviteteve					
Numri i aktiviteteve të implementuara					
Përqindja					



### 3.3 PROCEDURAT E ZGJEDHURA NGA DORACAKU I VEPRIMIT TË ZBATUARA NË TË GJITHA NJËSITË SPITALORE TË SHSKUK-SË

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Doracaku i veprimit përmban procedurat, rregulloret, dhe politikat që duhet të plotësohen, respektohen dhe implementohen nga ShSKUK-ja.

Ky Doracak përfshin gjashtë fusha kryesore siç janë: menaxhimi strategjik, menaxhimi dhe administrimi financiar, menaxhimi i potencialit njerëzor, prokurimi, dhe udhëheqja klinike. Ky indikator është i rëndësishëm se do të rregullojë në mënyrë detaje funksionimin operacional të të gjitha njësive përbërëse të ShSKUK-së.

Ky doracak do të revidohet nga Grupi Punues i ShSKUK dhe do të aprovohet nga Bordi drejtues i ShSKUK-së. Edhe pse indikatori synon të matë zbatimin e Doracakut, Doracaku fillimisht duhet të revidohet, kështu që ky formular do të trajtojë revidimin e Doracakut.

Afati kohor për revidimin e Doracakut është fundi i vitit 2018.

#### b) Parametrat që duhet matur

Të dhënat e nevojshme për të definuar këtë indikatorë janë:

- Data e aprovimit të doracakut të reviduar.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Të dhënat nuk janë mbledhur sipas metodës të marrjes së mostrave.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-se themelon grupin punues për revidimin e Doracakut.
- Hapi 2:** Të gjitha procedurat e përshkruara në Doracakun e aprovuar të vitit 2006, rishikohen në bazë të gjendjes aktuale nga grupi punues.
- Hapi 3:** Grupi punues përmes Drejtorit të përgjithshëm e përcjell draftin final të njësitë përbërëse të SHSKUK-së për diskutim publik, për vërejtjet apo sugjerime të mundshme.
- Hapi 4:** Grupi punues analizon të gjitha rekomandimet/sugjerimet e dhëna dhe i inkorporon në draftin final të Doracakut.
- Hapi 5:** Kryesuesi i grupit punues e dorëzon draftin final të Doracakut te Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së për aprovim.
- Hapi 6:** Drejtori i Përgjithshëm ShSKUK-së e përcjell draftin final te Bordi Drejtues i SHSKUK-se për aprovim.
- Hapi 7:** Bordi Drejtues i ShSKUK-së e aprovon Doracakun e reviduar i cili publikohet dhe i shpërndahet institucioneve përbërëse të ShSKUK-së.
- Hapi 8:** Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së, njofton Sekretarin e Përgjithshëm të MSH-së dhe Divizionin për M&V në MSH, për Doracakun e aprovuar nga Bordi Drejtues i ShSKUK-së.



**Hapi 9:** Divizioni i M&V në MSh bën analizën e vlerës së indikatorit dhe e paraqet në raportin gjashtë-mujor të M&V-së (tabela 1).

**e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të dhënave**

Mbledhje e njehershme (dhjetor 2018)

**f) Niveli fillestar**

0

**3.3 - Tabela 1. Analiza e vlerës së indikatorit.**

Doracaku i reviduar	Statusi	Komentet



### 3.3.1 STATUTET E 8 NJËSIVE SPITALORE TË SHSKUK-SË TË APROVUARA DERI NË FUND TË VITIT 2018 NGA MSH

#### a) Përkufizimi i indikatorit

*Ky indikator paraqet bazën e subjektivitetit juridik të njësive organizative të ShSKUK-së. Statuti i njësive organizative përmban:*

- Strukturën organizative dhe funksionale të njësive të ShSKUK-së,
- Shërbimet shëndetësore që ofrohen nga njësia përkatëse,
- Mënyrën e financimit të njësive.

*8 njësitë spitalore të ShSKUK-së janë:*

- Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK),
- Spitali i përgjithshëm i Mitrovicës,
- Spitali i përgjithshëm i Prizrenit,
- Spitali i përgjithshëm i Pejës,
- Spitali i përgjithshëm i Gjilanit,
- Spitali i përgjithshëm i Gjakovës
- Spitali i përgjithshëm i Ferizajt,
- Spitali i përgjithshëm i Vushtrrisë.

Statuti i njësive spitalore të ShSKUK-së është i rëndësishëm për shkak të ndryshimit thelbësor të sistemit shëndetësor përmes reformës së sektorit shëndetësor. Themelimi i ShSKUK-së si ofrues i shërbimeve shëndetësore, është ndarë nga menaxhimi institucional i MSh-së. Për këtë arsye, si institucion i ri, në të cilin janë organizuar shërbimet dytësore dhe tretësore shëndetësore, është e rëndësishme të definohen qartas strukturat organizative të saj.

*Indikatorit është i arritur dhe statuti i nënshkruar është i bashkëngjitur.*

#### b) Parametrat që duhet matur

*Të dhënat e nevojshme për të definuar këtë indikatorë janë:*

- Statutet e njësive spitalore.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Të dhënat nuk mblidhen përmes mostrimit, sepse të gjitha rastet merren parasysh për përcaktimin e vlerës së indikatorit.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

**Hapi 1:** Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-se themelon Grupet punuese për revidimin – hartimin e Statutit të SHSKUK dhe njësive përbërëse.

- Hapi 2:** Statuti ekzistues i SHKSUK, rishikohet në bazë të gjendjes aktuale nga Grupet punuese.
- Hapi 3:** Grupet punuese, përmes Drejtorit të Përgjithshëm, i përcjellin draftet finale të statuteve të njësitë përbërëse të SHSKUK-së për diskutim publik, për vërejtjet apo sugjerime të mundshme.
- Hapi 4:** Grupet punuese analizojnë të gjitha rekomandimet/sugjerimet e dhëna, dhe i inkorporojnë në draftet final të statuteve.
- Hapi 5:** Kryesuesit e Grupeve punuese i dorëzojnë draftet finale të statuteve të Drejtorit të Përgjithshëm i ShSKUK-së për aprovim.
- Hapi 6:** Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së, i përcjell draftet finale të Bordi Drejtues i SHSKUK-se për aprovim.
- Hapi 7:** Bordi Drejtues i ShSKUK-së i aprovon Statutet e SHKUK – së dhe nejsive ëpërbërëse, të cilat publikohen dhe i shpërndahen institucioneve përbërëse të ShSKUK-së.
- Hapi 8:** Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së, njofton Ministrinë Shëndetësisë, Sekretarin e Përgjithshëm të MSH-së dhe DMZHS - Divizionin për M&V në MSH, për Statutet e aprovuara nga Bordi Drejtues i ShSKUK-së.
- Hapi 9:** Divizioni i M&V në MSH bën analizën e vlerës së indikatorit dhe e paraqet në raportin gjashtë-mujor të M&V-së (tabela 1).

#### e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të dhënave

Mbledhje e njehershme (dhjetor 2018)

#### f) Niveli fillestar

Statuti ekzistues i SHSKUK – së

#### 4.1.1 – Tabela

Statutet e rishikuara - hartuara	Statusi	Komentet
Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)		
Spitali i përgjithshëm i Mitrovicës		
Spitali i përgjithshëm i Prizrenit		
Spitali i përgjithshëm i Pejës		
Spitali i përgjithshëm i Gjilanit		
Spitali i përgjithshëm i Gjakovës		
Spitali i përgjithshëm i Ferizajt		
Spitali i përgjithshëm i Vushtrrisë		



### 3.3.2 36 INSPEKTORË TË RINJ TË PUNËSUAR NË INSPEKTORATIN SHËNDETËSOR

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator përcakton numrin e inspektorëve të rinj shëndetësor të punësuar në inspektoratin shëndetësor në periudhën 2017-2021.

Inspektorati shëndetësor kryen mbikëqyrjen e jashtme të institucioneve shëndetësore, profesionistëve shëndetësor dhe personave që ofrojnë kujdes shëndetësor. ISh siguron zbatimin e akteve juridike, standardeve profesionale dhe normave etike në shëndetësi, me qëllim të arritjes, ruajtjes dhe rritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor. Në rast të parregullsive, ISh merr masa përkatëse ligjore, bashkëpunon me organet tjera dhe qytetarët, si dhe referon rastin të institucionet përkatëse.

Kapacitetet momentale të ISh janë 7 inspektorë të cilën kontrollojnë tërë territorin e Kosovës, ku mbulojnë rreth 1,500 institucione shëndetësore publike dhe private. Këto kapacitete nuk mundësojnë mbikëqyrje efektive të terrenit dhe është e domosdoshme rritja e kapaciteteve të Inspektoratit.

Indikatori do të disagregohet në bazë të gjinisë.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat kryesor që duhen matur janë:*

- # i inspektorëve të rinj të punësuar në ISh sipas gjinisë.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për matjen e indikatorit nuk përdoren metoda të përzgjedhjes së mostrës pasi që të gjithë të dhënat merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikatorit.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** Udhëheqësi i ISh-së bën planin e punësimit të inspektorëve të rinj në baza vjetore, duke u bazuar në SSSH 2017-2021, i cili miratohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm (ZSP).
- Hapi 2:** Udhëheqësi i ISh-së bën kërkesën te ZSP së bashku me përshkrimet e vendeve të punës, për hapjen e konkursit për rekrutim.
- Hapi 3:** ZSP aprovon fillimin e procedurave për rekrutim, e cila udhëhiqet nga Divizioni i burimeve njerëzore (DBNj) në MSh.
- Hapi 4:** DBNj bën kërkesën në Ministri të Administratës Publike (MAP) për aprovim të konkursit.
- Hapi 5:** DBNj udhëheq procedurat e rekrutimit deri në punësimin e inspektorëve të rinj.
- Hapi 6:** ZSP aprovon rekrutimin përfundimtar të inspektorëve të rinj.
- Hapi 7:** ISh dërgon regjistrin e të punësuarve të ri tek Divizioni i M&V-së në mënyrë elektronike ose me kopje fizike në baza vjetore (tabela 1).

**Hapi 6:** Vlera e këtij treguesi dhe një analizë e shkurtër e trendeve bëhet nga Divizioni i M&V-së dhe prezantohet në raportin vjetor të M&V-së duke përdorur tabelën 2.

**e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të dhënave**

Java e katërt e janarit, në baza vjetore.

**f) Niveli fillestar**

Niveli fillestar është 0, pasi ky është output indikator.

**3.3.2 - Tabela 1. Lista e inspektorëve të rinj të punësuar në ISh.**

#	Emri dhe mbiemri	Gjinia	Pozita	Viti i punësimit

**3.3.2 - Tabela 2. Të punësuarit në ISh sipas viteve.**

Vitet	Gjinia		Të punësuar total
	F	M	
2017			
2018			
2019			
2020			
2021			
<b>Totali</b>			



### 3.3.3 8 NJËSITË SPITALORE HARTOJNË PLANIN VJETOR TË ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator mat praninë e planit të nevojave për Zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZhVP).

Institucionet shëndetësore synojnë mirëmbajtjen e kapaciteteve si dhe zhvillimin e tyre, krahas zhvillimeve të mjekësisë së mbështetur në fakte. Planifikimi i nevojave për ZhVP është esencial për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, si dhe ngritjen e shërbimeve të reja.

Krahas zhvillimit të kapaciteteve profesionale, drejtori i secilit institucion harton dokumentin mbi nevojat për zhvillimin e vazhdueshëm profesional për secilin institucion, për vitin vijues. 8 njësitë spitalore janë:

Spitali i përgjithshëm i Pejës,  
Spitali i përgjithshëm i Prizrenit,  
Spitali i përgjithshëm i Gjakovës,  
Spitali i përgjithshëm i Gjilanit,  
Spitali i përgjithshëm i Mitrovicës,  
Spitali i përgjithshëm i Vushtrrisë,  
Spitali i përgjithshëm i Ferizajt dhe  
Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Dokumenti mbi nevojat për ZhVP përmban të paktën këto pjesë:

- Hyrje,
- Situata aktuale,
- Planet zhvillimore të institucionit,
- Nevojat për ZhVP konform planit zhvillimor,
- Plani i zbatimit (me afate kohore).

Ky indikator do të disagregohet në bazë të institucioneve shëndetësore.

#### b) Parametrat që duhet matur

Parametrat kryesorë të mbledhur për përkufizimin e indikatorit janë:

- # i planeve vjetore i ZhVP-së.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Ky indikator nuk llogaritet me anë të mostrës, pasi që të gjithë parametrat do të merren parasysht për përcaktimin e vlerës së tij.





### 3.3.4 SHËRBIMET E PAKOS BAZIKE TË KONTRAKTUARA ME SECILËN NJËSI TË SHSKUK-SË

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator numrin e shërbimeve shëndetësore, të disagreguar sipas llojit, të cilat kontrahohen në mes të Fondit të Sigurimit Shëndetësor (FSSH) dhe institucioneve shëndetësore dytësore dhe tretësore.

Kontraktimi i shërbimeve të pakos bazike përmirëson cilësinë, racionalizon ofrimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve, rritë përgjegjësinë e institucioneve dytësore dhe tretësore shëndetësore dhe racionalizon shfrytëzimin e mjeteve financiare.

FSSH nënshkruan dy lloje të kontratave me institucionet shëndetësore. Kontrata e përgjithshme, e cila lidhet në mes të FSSH-së dhe ShSKUK-së, mbi parimet e përgjithshme, si dhe kontratat specifike me secilin institucion – njësi organizative të ShSKUK-së. Njësi organizative të ShSKUK-së janë Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Qendra Stomatologjike Universitare e Kosovës, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Sportit, 7 spitalet e përgjithshme, 7 qendrat regjionale të shëndetit mendor me shtëpitë për integrim në bashkësi, Qendra për integrim dhe rehabilitim të të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime (QIRSKP).

#### b) Parametrat që duhet matur

- # i kontratave të nënshkuara.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Ky indikator nuk përdor mostër, sepse të gjitha rastet merren parasysh për përcaktimin e vlerës së indikatorit.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** FSSH lidh kontratën e përgjithshme me ShSKUK-në në baza vjetore, në fund të vitit për vitin vijues.
- Hapi 2:** FSSH nënshkruan kontrata specifike me secilën njësi organizative të ShSKUK-së në baza vjetore.
- Hapi 3:** Drejtori i FSSH-së, raporton në mënyrë elektronike në Divizionin e M&V-së në MSh mbi numrin e kontratave të nënshkuara me njësitë organizative të ShSKUK-së.
- Hapi 4:** Udhëheqësi i Divizionit të M&V-së në MSh përfshin të dhënat mbi numrin e kontratave në raportin vjetor të M&V-së (tabela 1).
- Hapi 5:** FSSH bën analizimin e të dhënave mbi numrin e kontratave të nënshkuara në mes të FSSH-së dhe njërive të ShSKUK-së.

#### e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave

Janar, në baza vjetore.



**f) Niveli fillestar**

0

**3.3.4 - Tabela 1. Kontratat e nënshkruara të ShSKUK-së.**

Njësitë e SHSKUK	Statusi	Komentet
n		



### 3.4 80% E EKIPEVE TË MJEKËSISË FAMILJARE KANË LISTAT E PACIENTËVE

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator paraqet raportin në mes numrit të përgjithshëm të ekipeve të mjekësisë familjare me numrin e listave të pacientëve.

Implementimi i mjekësisë familjare parasheh që secili banor të përzgjedh mjekun e tij dhe të jetë i regjistruar në regjistrin e një ekipi gjegjë. Koncepti i mjekësisë familjare është i pranuar si gurëthemel i sistemit shëndetësor, por për shkak të rrethanave (mungesa e sigurimit shëndetësor, mungesa e Sistemit të informimit shëndetësor, etj.), ky koncept nuk ka mundur të implementohet tërësisht. Krijimi i listave të pacientëve është bazë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore të bazuar në mjekësinë familjare. Parashihet që një ekip i mjekësisë familjare të përkujdeset për 2000 banorë.

*Një ekip i mjekësisë familjare përbëhet nga:*

- 1 mjek familjar (në vend të mjekut familjar mund të jetë mjeku i përgjithshëm deri në plotësimin e standardit 1 mjek familjar për 2000 banorë),
- 2 infermierë familjarë.

Indikatorit kalkulohet përmes formulës:

$(\text{Numri i ekipeve/numrin e listave}) \times 100 = \text{Vlera e indikatorit}$

*Kujdesi parësor shëndetësor në Kosovë, i cili ka mandatin për ta implementuar konceptin e mjekësisë familjare, organizohet bazuar në këtë strukturë:*

- Secila komunë ka Qendrën kryesore të mjekësisë familjare (QKMF), e cila koordinon shërbimet e KPSH dhe mbledh të dhënat në nivel komunal nga të gjitha institucionet e KPSH-së në komunën përkatëse;
- Secila QKMF, varësisht nga madhësia e komunës, ka disa Qendra të mjekësisë familjare (QMF) dhe Ambulanta të mjekësisë familjare (AMF).

Divizioni i kujdesit parësor shëndetësor do të bëjë mbledhjen e të dhënave nga të gjitha QKMF-të, sa i përket listës së pacientëve.

Ky indikator disagregohet në bazë të komunës.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat kryesorë të mbledhur për të përkufizuar indikatorët janë:*

- Numri i ekipeve të mjekësisë familjare disagreguar sipas komunës,
- Numri i listave të krijuara me së paku 10 pacientë të regjistruar.

### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për matjen e indikatorit nuk përdoren metoda të përzgjedhjes së mostrës, pasi që të gjithë ekipet e mjekësisë familjare merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikator.

### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

*Vlera e këtij indikator përftohet me anë të këtyre hapave:*

- Hapi 1:** DKPSh bën përditësimin e rrjetit të institucioneve në KPSh në baza vjetore (tabela 1).
- Hapi 2:** Drejtorët e QKMF-ve raportojnë tabelën 2 ku paraqiten numri i ekipeve të mjekësisë familjare dhe i listës së pacientëve për ekip, në DKPSh.
- Hapi 3:** DKPSh do të bëjë kontrollin e cilësisë për së paku 10% e të dhënave të kësaj liste.
- Hapi 4:** DKPSh bën agregimin e të dhënave dhe i procedon tek divizioni i M&V-së në MSh, sipas tabelës 3.
- Hapi 5:** DKPSh përcakton vlerën e indikatorit duke përdorur formulën e sipërpërmendur, në tabelën 4.
- Hapi 6:** Divizioni i M&V-së do t'i përfshijë të dhënat e raportit në Matricën e Monitorimit dhe Vlerësimit.
- Hapi 7:** Të dhënat prezantohen në raportet e Monitorimit dhe Vlerësimit të MSh-së një herë në vit.
- Hapi 8:** Divizioni i KPSh-së bën analizën e përmbledhur të trendeve. Vlera e indikatorit prezantohet në raportin vjetor të MV-së sipas formatit të propozuar në tabelën 4.

### e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të dhënave

Ky indikator matet një herë në vit në fund të nëntorit nga ana e QZhMF-së.

### f) Niveli fillestar

Të dhënat për nivelin fillestar janë 0, për shkak se ky është aktiviteti i ri.



### 3.4 - Tabela 1. Rrjeti i institucioneve të KPSH.

Nr.	Vendi	QKMF	QMF	AMF	Gjithsejt
1.	Prishtinë	1	12 QMF (DAT, Poliklinika stomatol.)	15	29
2.	Fushë Kosovë	1	3	3	7
3.	Kastriot	1	2	5	8
4.	Lipjan	1	4	6	11
5.	Drenas	1	5	7	13
6.	Podujevë	1	15	7	23
7.	Gjilan	1	12	10	23
8.	Kamenicë	1	3	18	22
9.	Novobërdë	1	2	6	9
10.	Ferizaj	1	3	13	17
11.	Kaçanik	1	2	7	10
12.	Hani i Elezit	1		1	2
13.	Viti	1	3	8	12
14.	Shtime	1	3		4
15.	Mitrovicë	1	8	14	23
16.	Vushtrri	1	8	8	17
17.	Skenderaj	1	5	8	14
18.	Peja	1	14 (Poliklinika Stomatologji.)	9	25
19.	Istog	1	4	8	13
20.	Klinë	1	4	11	16
21.	Deçan	1	3	6	10
22.	Junik	1			1
23.	Gjakovë	1	10	16	27
24.	Prizren	1	14	26	41
25.	Therandë	1	6	7	14
26.	Rahovec	1	6	2	9
27.	Malishevë	1	7	5	13
28.	Mamushë		<b>1</b>		<b>1</b>
29.	Dragash	1	5	8	14
30.	Klllokot				
31.	Partesh				
32.	Graçanicë				
33.	Shtërpcë				





### 3.4.1 250 MJEKË FAMILJARË TË PËRFSHIRË NË SHKOLLIMIN SPECIALISTIK POST-DIPLOMIK NË MJEKËSI FAMILJARE (TË PLOTËSOHET STANDARDI 1 MF PËR 2000 BANORË)

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator paraqet numrin kumulativ të mjekëve familjarë të regjistruar në specializim për mjekësi familjare nga viti 2011.

Specializimi në mjekësi familjare zgjat tre vjet dhe ofrohet nga Divizioni i Kujdesit parësor shëndetësor DKPSh i MSh-së. Specializimi në MF është i akredituar nga Kolegji mbretëror i Anglisë (RCGP) nga viti 2015. Qëllimi i këtij programi është që të arrihet standardi një mjek familjar për 2000 banorë, duke iu përmbajtur një standardi të cilësisë të përcaktuar nga RCGP. Të gjithë të përfshirët në specializim nga viti 2011, përfundojnë specializimin nga programi i akredituar nga RCGP.

Koncepti i mjekësisë familjare është i pranuar si gurëthemel i sistemit shëndetësor, sepse është porta hyrëse në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Në mënyrë që ky koncept të zbatohet, numri i mjekëve të specializuar në mjekësi familjare duhet rritur në bazë të standardit të lartpërmendur.

Indikatorit përlllogaritet sipas komunave dhe gjinisë.

#### b) Parametrat që duhet matur

Parametrat kryesorë të mbledhur për të përkufizuar indikatorët janë:

- Numri i mjekëve të regjistruar në specializim për mjekësi familjare, të regjistruar në QZHMf nga viti 2011.
- Komuna që ka lejuar programin e specializimit.
- Gjinia e mjekut.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Indikatorit nuk llogaritet me anë të mostrës, pasi që të gjithë mjekët familjarë të regjistruar në specializim për mjekësi familjare merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikatorit.

#### d) Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Vlera e këtij indikatorit fitohet me anë të hapave të mëposhtëm:

- Hapi 1:** Komiteti përkatës harton planin e Shkollimit Specialistik dhe e miraton Bordi Qendror për Shkollim Specialistik në MSh.
- Hapi 2:** MSh hap konkursin për Specializim në Mjekësi Familjare në bazë të nevojave të institucioneve të KPSh.
- Hapi 3:** Bordi i Specializimeve i MSh-së vlerëson aplikacionet e mjekëve dhe interviston kandidatët, dhe në bazë të rezultateve u ndan specializimet kandidatëve.
- Hapi 4:** Drejtorët e QKMF-ve bëjnë aprovimin e kandidatëve të përzgjedhur për komunën përkatëse.
- Hapi 5:** Mjekët e përzgjedhur për mjekësi familjare fillojnë specializimin për mjekësi familjare në DKPSh dhe Qendrat trajnuese të mjekësisë familjare (QTMF).



- Hapi 6:** Në baza vjetore DKPSh përgatit raport me të dhënat mbi regjistrimin (tabela 1).  
**Hapi 7:** Të dhënat dërgohen në baza vjetore përmes adresës elektronike nga DKPSh në Divizionin e M&V duke përdorur tabelën 2.  
**Hapi 8:** Të dhënat prezantohen në raportet vjetore të M&V të MSh-së duke përdorur tabelën 3.  
**Hapi 9:** Vlera e indikatorit dhe analiza e shkurtër e trendeve të tij bëhet nga DKPSh të MSh-së duke përdorur tabelën 3 dhe prezantohen në raportin vjetor të M&V-së.

#### e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave

Java e parë e dhjetorit, çdo vit.

#### f) Gjendja fillestare

Të dhënat lidhur me gjendjen fillestare janë paraqitur në tabelën 4.

#### 3.4.1 - Tabela 1. Lista e përfshirjes në programin e specializimit të MF-së.

Lista e specializantëve në shkollimin specialistik në MF								
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Viti i lindjes	Komuna	Vendbanimi	Vendi i punës	Nr i vendimit ESP	Nr- Personal	Telefoni
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								

#### 3.4.1 - Tabela 2. Mjekët e përfshirë në programin specialistik në mjekësi familjare sipas gjinisë dhe komunës.

Komuna	F	M	Total
Ferizaj			
Gjakovë			
Gjilan			
Lipjan			
Mitrovicë			
Pejë			
Prishtinë			
Prizren			
"n"			
<b>Grand Total</b>			



**3.4.1 - Tabela 3. Të dhënat e përfshirjes në programin specialistik në MF.**

Mjekët e përfshirë	
Viti	Numri
<b>Totali</b>	

**3.4.1 - Tabela 4. Të dhënat fillestare.**

Mjekët e përfshirë	
2011-2015	76
2012-2016	24
2015-2018	50
<b>Total</b>	<b>150</b>



### 3.4.2 100% TË MENAXHERËVE TË QKMF-VE TË TRAJNUAR PËR SHKATHTËSI BAZIKE MENAXHERIALE

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator paraqet trajnimin e drejtorëve të të gjitha QKMF-ve, kryeshefat e departamenteve si dhe përgjegjësit e sektorëve, në shkathtësitë bazike menaxheriale.

*Shkathtësitë bazike menaxheriale përmban këto module:*

- Menaxhimi i financave,
- Menaxhimi i resurseve shëndetësore,
- Planifikimi dhe implementimi i shërbimeve të KPSH-së,
- Monitorimi dhe vlerësimi,
- Menaxhimi, lidërshtipi dhe partneriteti,
- Menaxhimi i cilësisë.

Këto trajnime janë të planifikuara të ofrohen nga projekti AQH (Accessible Quality Healthcare), i cili do të përkujdeset për përzgjedhjen e trajnerëve. Divizioni i KPSH-së në MSh është përgjegjës për përcjelljen e implementimit të projektit AQH.

I trajnuar konsiderohet menaxheri i cili ka marrë pjesë në 70% të moduleve/ seancave trajnuese, rrjedhimisht është certifikuar për trajnimin.

Trajnimet do të ofrohen përmes punëtorive/ moduleve me total prej 16 ditëve.

Indikatorit disagregohet në nivel të komunave, pozitës dhe gjinisë.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat kryesorë të mbledhur për të përkufizuar indikatorët janë:*

- Numri i drejtorëve të QKMF-ve, kryeshefave të departamenteve si dhe përgjegjësve të sektorëve të trajnuar, disagreguar sipas komunave, pozitës dhe gjinisë.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për matjen e indikatorit nuk përdoren metoda të përzgjedhjes së mostrës, pasi që të gjitha rastet merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikatorit.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

*Vlera e këtij indikatorit përftohet me anë të këtyre hapave:*

**Hapi 1:** Kryeshefi i Mjekësisë Familjare i secilës QKMF përpilon listat e personelit që do të trajnohet, në bazë të organogramit dhe i dërgon në DKPSH (tabela 1).

**Hapi 2:** DKPSH do të bëjë kontrollin e cilësisë për së paku 10% e të dhënave të kësaj liste, për të verifikuar nëse personat e ftuar kanë pozitën e cekura menaxheriale.





### 3.4.3 PLANI OPERATIV PËR PROMOVIM TË KONCEPTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE I PËRPI-LUAR ÇDO VIT DUKE FILLUAR NGA 2018

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator mat prezencën e planit operativ për promovim të konceptit të mjekësisë familjare të aprovuar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm (ZSP) të MSh-së.

Koncepti i mjekësisë familjare është i pranuar si gurëthemel i sistemit shëndetësor, por për shkak të rrethanave (mungesa e sigurimit shëndetësor, mungesa e Sistemit të informimit shëndetësor, etj.), ky koncept nuk ka mundur të implementohet tërësisht. Vetëdijesimi i popullatës mbi konceptin e mjekësisë familjare është esencial për implementimin e këtij koncepti. Deri tash, përveç ndonjë nisme lokale, nuk ka pasur ndonjë fushatë në nivel vendi, për ta promovuar këtë koncept.

MSh ka planifikuar përpilimin e planit operativ, ku do të parashihen fushatat dhe aktivitetet tjera promovuese që do të zbatohen gjatë periudhës 3 vjeçare, duke u përditësuar çdo vit.

*Plani operativ për promovimin e konceptit të mjekësisë familjare do të përmbajë këto elemente:*

- Hyrje,
- Aktivitetet,
- Afatet kohore,
- Buxheti,
- Institucionet përgjegjëse.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat që duhen matur për përcaktimin e vlerës së indikatorit janë:*

- Plani operativ i nënshkruar nga ZSP.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për përcaktimin e vlerës së këtij indikator nuk kemi përzgjedhje të mostrës, sepse të gjitha rastet merren parasysh.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** ZSP formon grupin punues për hartimin e planit operativ për promovimin e konceptit të mjekësisë familjare, me propozim nga DKPSh.
- Hapi 2:** Grupi punues përpilon draftin e planit operativ për promovimin e konceptit të MF-së.
- Hapi 3:** ZSP aprovon planin operativ.
- Hapi 4:** DKPSh raporton në baza vjetore tek DMV mbi aprovimin e planit operativ.
- Hapi 5:** DMV bën analizën e vlerës së indikatorit dhe paraqet të dhënat mbi këtë indikator në raportin vjetor të M&V-së së MSh-së (tabela 1).



### e) Periudha dhe shpeshtësia e grumbullimit të dhënave

Fundi i janarit, në baza vjetore.

### f) Niveli fillestar

Të dhënat fillestare për indikatorin janë 0.

#### 3.4.3 - Tabela 1. Analiza e vlerës së indikatorit.

Plani operativ për promovimin e konceptit të mjekësisë familjare	Statusi (po/ jo)	Komentet
Hyrje		
Aktivitetet		
Afatet kohore		
Buxheti		
Institucionet përgjegjëse		

### 3.4.4 90% E INSTITUCIONEVE NË KPSH JANË TË FURNIZUARA ME PAJISJET BAZIKE PËR SHËRBIMET E MF

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator mat përqindjen e furnizimit të institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor (KPSH) me pajisje bazike.

Lista e pajisjeve bazike së bashku me standardet e caktuara për numrin e pajisjeve për institucion, do të përcaktohen me Udhëzimin administrativ, i cili është duke u hartuar nga MSh.

Furnizimi me pajisje bazike ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në institucionet e KPSH-së. MSh ka bërë prioritet të sektorit kujdesin parësor shëndetësor, si bazë të kujdesit shëndetësor për qytetarët.

Ky indikator do të disagregohet në bazë të komunave.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat që duhen matur për përcaktimin e vlerës së indikatorit janë:*

- % e furnizimit me pajisje bazike sipas komunave.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për përcaktimin e vlerës së këtij indikatorit nuk kemi përzgjedhje të mostrës sepse të gjitha rastet merren parasysh.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** Divizioni i KPSH-së do të realizojë hulumtim mbi disponueshmërinë e institucioneve të KPSH-së me pajisje bazike, në bazë të standardeve të përcaktuara në UA.
- Hapi 2:** Divizioni i KPSH-së do të përpilojë raport bazuar në hulumtimin e kryer (tabela 1)<sup>7</sup>.
- Hapi 3:** Të dhënat mbi vlerën e indikatorit të disagreguara në bazë të komunave, i dërgohen në mënyrë elektronike Divizionit të M&V-së (tabela 2)<sup>8</sup>.
- Hapi 4:** Divizioni i KPSH-së bën një analizë të shkurtër të trendeve
- Hapi 5:** Divizioni i M&V-së i prezanton në raportin vjetor të M&V-së (tabela 3)<sup>9</sup>.

#### e) Periudha dhe shpeshësia e grumbullimit të dhënave

Fundi i janarit, në baza vjetore.

#### f) Niveli fillestar

Të dhënat fillestare për indikatorin nuk janë të disponueshme.

<sup>7</sup> Tabelat do të dizajnohen pas përpilimit të Udhëzimit administrative, ku do të përcaktohen standardet e pajisjeve bazike.

<sup>8</sup> Tabelat do të dizajnohen pas përpilimit të Udhëzimit administrative, ku do të përcaktohen standardet e pajisjeve bazike.

<sup>9</sup> Tabelat do të dizajnohen pas përpilimit të Udhëzimit administrative, ku do të përcaktohen standardet e pajisjeve bazike.



### 3.4.5 90% E INSTITUCIONEVE NË KPSH ZBATOJNË STANDARDET E ZGJEDHURA

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator paraqet shkallën e zbatimit të standardeve të zgjedhura nga pakoja e standardeve për shërbimet në Kujdesin parësor shëndetësor. Standardet e kujdesit shëndetësor përcaktojnë nëse një spital apo entitet klinik i nivelit parësor funksionon në mënyrë efikase dhe efçente, apo se sa profesionistët shëndetësor i zbatojnë procedurat klinike, rrjedhimisht është një indikator i rëndësishëm.

Standardet për Kujdesin shëndetësor parësor janë të vjetruara (nga viti 2005), dhe si të tilla kanë nevojë për përditësim. Në planin e punës së Departamentit për zhvillim strategjik (DZhSh) në MSh, gjegjësisht Divizionit për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore (DCSShSh), është planifikuar që gjatë vitit 2018 të bëhet revidimi i pakos së standardeve. Me revidimin e pakos, do të bëhet përzgjedhja e standardeve për monitorim, si dhe përcaktimi i parametrave që definojnë implementimin e tyre.

*Formula e kalkulimit të standardeve është:*

$(\# \text{ i standardeve të plotësuara} / \# \text{ i standardeve të përzgjedhura}) * 100 = \text{vlera e indikatorit (\%)}$ .

Indikatorin do të disagregohet në bazë të institucioneve (QKMF) nëpër komuna.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat kryesor që duhen matur janë:*

- # i standardeve të përzgjedhura,
- # i standardeve të plotësuara i disagreguar në bazë të QKMF-ve.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Indikatorin nuk përdorë mostër, pasi të gjitha institucionet do të merren parasysh për gjenerimin e këtij indikatorit.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** Sekretari i Përgjithshëm emëron grupin punues për revidimin e standardeve.
- Hapi 2:** Grupi punues harton draftin final të standardeve dhe e dërgon për aprovim te SP i MSh-së.
- Hapi 3:** Standardet e aprovuara i dërgohen të gjitha institucioneve shëndetësore të nivelit parësor.
- Hapi 4:** Koordinatorin i cilësisë nga secila Qendër kryesore e mjekësisë familjare (QKMF) përgatit raportin mbi implementimin e standardeve dhe e dërgon në DCSShSh dhe DKPSH në MSh (tabela 1).
- Hapi 5:** DKPSH agregon dhe analizon të dhënat për të gjitha institucionet në KPSH dhe i dërgon në mënyrë elektronike te DMV në MSh raportin e implementimit të standardeve (tabela 2 dhe 3).



**Hapi 6:** Vlera e këtij treguesi prezantohet në raportin vjetor të M&V-së nga Divizioni i M&V-së (tabela 3).

#### e) Periudha dhe shpeshësia e grumbullimit të dhënave

Java e parë e marsit, në baza vjetore.

#### f) Niveli fillestar

Të dhënat për nivelin fillestar nuk janë të disponueshme.

### 3.4.5 - Tabela 1. Lista e standardeve të kujdesit shëndetësor parësor.

Emri i standardit	Statusi	Koment

### 3.4.5 - Tabela 2. Kalkulimi i implementimit të standardeve të përzgjedhura në institucionin shëndetësor parësor (QKMF).

Emri i institucionit:		
a) Numri i standardeve të përzgjedhura	b) Numri i standardeve të plotësuara	% e standardeve të plotësuara (b/a*100)

### 3.4.5 - Tabela 3. Implementimi i standardeve të përzgjedhura në të gjitha institucionet parësore.

Emri i institucionit	a) Numri i standardeve të përzgjedhura	b) Numri i standardeve të plotësuara	% e standardeve të plotësuara (b/a*100)
<b>Totali</b>			



### 3.4.6 20 UPK TË APROVUARA DHE SHPËRNDARA NË TË GJITHA INSTITUCIONET E KPSH DERI NË FUND TË VITIT 2018

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator paraqet numrin e Udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike (UPK) nacionale, të aprovuara në MSh, në bazë të të cilave ofrohen shërbimet shëndetësore në KPSH.

UPK-të e aprovuara shpërndahen në të gjitha QKMF-të, të cilat shpërndajnë në degët e tyre: QMF dhe AMF.

Metodologjia e hartimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike (UPK) nacionale është e rregulluar në bazë të UA 08/2015 për UPK. Përmes zbatimit të UPK-ve, synohet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore, bazuar në praktikën më të mirë mjekësore, ndërlidhur me mjekësinë e bazuar në dëshmi.

Këshilli Kosovar për UPK (KKUPK) është organ ndërlidhës i cili i propozon Ministrit të Shëndetësisë temat prioritare për hartim të UPK-ve, aprovimin gjegjësisht revokimin e UPK-ve. KKUPK i propozon Ministrit anëtarësinë e grupeve punuese për përpilimin e UPK-ve, në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Komisioni për vlerësimin e metodologjisë së hartimit të UPK-ve është organ i cili bën vlerësimin e metodologjisë së hartimit të UPK-ve bazuar në instrumentin e përcaktuar në UA 08/2015, i quajtur AGREE.

Grupet për hartimin e UPK-ve përbëhen nga profesionistët shëndetësor dhe jo-shëndetësor të cilët përzgjedhen varësisht nga tema specifike për të cilën hartohet një UPK i caktuar. Për shkak të ndryshimit të metodologjisë së punës, MSh ka ricaktuar cakun vjetor të UPK-ve për KPSH, dhe në vend të 20 sa janë planifikuar më parë, për vitin 2017, parashihet të zhvillohen 3 UPK.

Ky indikator disagregohet në bazë të regjioneve dhe UPK-ve të aprovuara.

#### b) Parametrat që duhet matur

*Parametrat kryesor që duhen matur janë:*

- Numri i UPK-ve të nënshkruara dhe shpërndara në institucionet e KPSH-së, disagreguar në bazë të regjioneve dhe UPK-ve të aprovuara.

#### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për matjen e indikatorit nuk përdoren metoda të përzgjedhjes së mostrës, pasi që të gjithë rastet merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikator.

#### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** KKUPK i propozon Ministrit temat prioritare për hartim të UPK-ve, të cilat përcaktohen bazuar në listën e kriterëve të aprovuar nga MSh (tabela 1).
- Hapi 2:** Pas aprovimit të temave prioritare, KKUPK propozon anëtarësinë e GP-ve të cilat hartojnë UPK-të, me aprovim të Ministrit.
- Hapi 3:** Pas procedurave të përcaktuara me UA (draftimi i UPK-së nga GP, recensentët senior, konsultimi publik, vlerësimi nga KVMHUPK dhe aprovimit nga Ministri), UPK-të shpërndahen në institucione përkatëse nga Divizioni i cilësisë dhe sigurisë së ShSh në MSh (tabela 2).
- Hapi 4:** Të dhënat agregohen dhe analizohen nga DCSShSh duke përdorur tabelën për analizimin e të dhënave të këtij indikatorit (tabela 3).
- Hapi 5:** DCSShSh dorëzon të dhënat mbi UPK-të e nënshkruara dhe shpërndara tek Divizioni i M&V-së në MSh (lista e UPK-ve).
- Hapi 6:** DCSShSh bën analizën e trendeve dhe dorëzon raportin te Divizioni i M&V-së në MSh.
- Hapi 7:** DMZHS - Divizioni i M&V-së jep rekomandimet mbi përmirësimin e vlerësimit indikatorit.
- Hapi 8:** Vlera e këtij treguesi prezantohet në raportin vjetor të M&V-së nga Divizioni i M&V-së (tabela 3).

#### e) Periudha dhe shpeshësia e grumbullimit të dhënave

Java e parë e shkurtit, në baza vjetore.

#### f) Niveli fillestar

Të dhënat për nivelin fillestar janë 0, pasi që ende nuk është aprovuar asnjë UPK nacional.

#### 3.4.6 - Tabela 1. Kriteret për përzgjedhjen e temës prioritare për UPK.

KRITERET	Vlerësimi i temave (nga 1-5 pikë)						
	1	2	3	4	5	6	7
A është kjo fushë e lidhur me vdekshmëri të lartë? Vdekshmëri e lartë > prioritet i lartë							
A është kjo fushë e lidhur me sëmundshmëri të lartë? Sëmundshmëri e lartë > prioritet i lartë							
A ka gjasa të zvogëlohet vdekshmëria pas përmirësimit të shërbimeve shëndetësore? Po > prioritet i lartë							
A ka gjasa të zvogëlohet sëmundshmëria pas përmirësimit të shërbimeve shëndetësore? Po > prioritet i lartë							
Sa është incidenca e problemit në popullatën lokale? Incidenca e lartë > prioritet i lartë							



### 3.5 TË GJITHË STACIONET E PUNËS SË SISH-IT NË TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE KANË QASJE NË SISTEMIN INFORMATIV SHËNDETËSOR DERI NË FUND TË 2018-ës

#### a) Përkufizimi i indikatorit

Ky indikator paraqet raportin ndërmjet numrit të përgjithshëm të punonjësve në institucionet shëndetësore publike të ndarë sipas mjekëve, infermierëve dhe punëtorëve të administratës dhe pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të stacioneve të punës së SISH-it.

Sistemi SISH nënkupton infrastrukturën harduerike dhe softuerin përkatës. Hardueri i SISH-it përbëhet nga:

a) stacionet e punës së SISH-it, b) LAN-i, c) lidhja WAN dhe d) Infrastruktura e Qendrës së të Dhënave.

Softueri i SISH-it përbëhet nga produkti i blerë i quajtur Avicenna dhe integrimet shoqëruese me regjistrat e jashtëm.

*Një stacion i punës së SISH-it i destinuar për mjekët dhe infermierët përbëhet nga:*

- **1 Klienti zero** i lidhur me **Qendrën e të Dhënave** përmes infrastrukturës LAN të destinuar për SISH dhe menaxhohet nga Qendra Operative e Rrjetit – QORr (në kuadër të Departamentit të SISH-it në MSh)

*Një stacion i punës së SISH-it i destinuar për recepsion përbëhet nga:*

- **1 zero klient** i lidhur me **Qendrën e të Dhënave** përmes infrastrukturës LAN të caktuar për SISH dhe menaxhohet nga QORr;
- **1 lexues i barkodit.**

Të gjithë stacionet e punës së SISH-it kanë qasje në një printer të afërt (në katin ose departamentin e njëjtë ku ndodhet stacioni i punës së SISH-it).

*Shpërndarja e stacioneve të punës së SISH-it bëhet sipas kësaj skeme:*

- 1 stacion i punës për çdo 2 mjekë
- 1 stacion i punës për çdo 5 infermierë
- 1 stacion i punës për çdo 6 punëtorë të administratës

*Qasja në sistem e të gjithë ISHP-ve përkufizohet si:*

Infrastruktura e SISH-it është instaluar dhe funksionon sipas kritereve që maten me anë të përlogaritjes së stacioneve të punës që nuk kanë funksionuar për më shumë se 3 ditë prej momentit të raportimit.

#### b) Parametrat që duhet matur

Parametrat kryesorë të mbledhur për të përkufizuar indikatorët janë:

- Numri i përgjithshëm i punonjësve në institucionet shëndetësore publike, ndarë sipas rajonit, komunës, institucionit shëndetësor, mjekëve, infermierëve dhe punëtorë administrativ;
- Numri i përgjithshëm i stacioneve të punës së SISH-it, ndarë sipas rajoneve, komunave dhe institucionit shëndetësor.



### c) Metoda e përzgjedhjes së mostrës

Për matjen e indikatorit nuk përdoren metoda të përzgjedhjes së mostrës, pasi që të gjithë stacionet e punës së SISH-it në të gjitha institucionet shëndetësore publike me qasje në SISH merren parasysh për përcaktimin e vlerës së këtij indikatorit.

### d) Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

- Hapi 1:** Lista e të gjitha Institucioneve Shëndetësore Publike të ndarë sipas rajonit dhe komunës përditësohet dy herë në vit nga QORr-i (shih formatin në tabelën 1).
- Hapi 2:** Lista e të gjithë punonjësve të institucioneve shëndetësore publike të ndarë sipas rajonit, komunës, institucionit shëndetësor, mjekëve, infermierëve dhe punëtorëve të administratës, përditësohet dy herë në vit nga QORr-i (shih formatin në tabelën 2).
- Hapi 3:** Dy herë në vit QORr-i përgatit dhe dorëzon inventarin (shih formatin në tabelën 3) të të gjitha stacionet e punës së SISH-it të shpërndarë në të gjitha IShP-të.
- Hapi 4:** QORr-i ofron raportin e konektivitetit të stacioneve të punës së SISH-it, për kontrollimin e disponueshmërisë dhe funksionimit të infrastrukturës harduerike të SISH-it (tabela 4).
- Hapi 5:** Për çdo Institucion Shëndetësor Publik, përllogaritet shpërndarja e stacioneve të punës së SISH-it duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$100 * \left( \frac{K}{rrumbullaksim\left(\frac{M}{2}\right) + rrumbullaksim\left(\frac{I}{5}\right) + rrumbullaksim\left(\frac{A}{6}\right)} \right)$$

*Ku:*

*M: Numri i mjekëve*

*I: Numri i infermierëve*

